Muhamet Çami



Jusufi e Zylejhaja

MUHAMET ÇAMI

JUSUFI E ZULEJHAJA

(DASHURI PËRVËLUESE)

Shtëpia Botuese Vetjake «HASAN TAHSINI»

Tiranë, 1992

Redaktor: Zuheir Shaban Naimi

Recensentë: Dalan Shapllo
Dashamir Toska

Mbulesa: Spiro Kristo

PARATHËNIE

«Jusufi e Zulejhaja» është vepra më e arrirë, më e bukur dhe më tërheqëse e Muhamet Çamit apo «kryevepra e tij», siç shkruajnë disa; ajo endet në 2432 vargje 8-rrokësh. Në to tirren ngjarje të lashtësisë, të cilat në vija të trasha shtjellohen si tregim edhe në 16 faqe të Kuranit. Po, meqë ngjarjet e përshkruara në to s'ishin të mjaftueshme për thurjen e një vepre të plotë letrare dhe, me qëllim që vepra të mos mbetej si përrallë njerëzish e vendesh të huaja po të merrte disi një pamje jetësore shqiptare, Muhamet Çami e pasuroi tregimin me ndodhi plotësuese të ndërmjeme e hollësi të domosdoshme e kështu ia rriti ndiesitë: lëndimet, ankthet, ngazëllimet dhe ngacmime të tjera shpirtërore, gjë që e bën lexuesin të presë me padurim të hasë ngjarje pas ngjarjesh. Duke qenë se ai tregim biblik-kuranik ka qenë shtjelluar nga mjaft vjershëtarë e shkrimtarë arabë, osmanë e persianë — ndër të parët e tyre edhe nga vjershëtari taxhik në zë Firdaisi, vargëzuesi i mirënjohur i «Shahnamesë» — s'përjashtohet rasti që për pasurimin, shtimin a zbukurimin e ndodhive Muhamet Çami të jetë ndihmuar edhe nga veprat e tyre. Pas Muhamet Çamit tregimin mbi Jusufin e Zulejhanë e kanë përpunuar edhe vjershëtarë të tjerë shqip-

tarë, po në mënyra të ndryshme nga njëri-tjetri, nga sa dihet, ndër ta kanë qenë edhe Dalip Frashëri, hafëz Ali Korça, Sami Frashëri e Çajupi. Boshti rreth të cilit përqëndrohen dhe vërtiten thuajse tërë pjesëmarrësit në ngjarjet e shumta që përshkruhen në vepër janë Jusufi — i biri i 12-të i Jakup Qenanit, mbretit të Palestinës — dhe Zulejhaja, e shoqja e Katfirit — ministrit të tërë fuqishëm në Oborrin e mbretit të Misirit, Rrejanit; vepra fillon me ndodhitë shumë tronditëse e rrënqethëse që ngjasin në familjen sundimtare të qenanejve, familje që mbahet si sunduese zanafillëse në atë pjesë të botës. Në këtë vepër — sikur edhe në tërë veprat e tjera mësimdhënëse — Muhamet Çami qorton me rreptësinë më të madhe cmirën, pabesinë, keqbërësinë, dehjen nga të mirat dhe pushteti, mosmirënjohjen, pamëshirësinë, moskokëçarjen, pakujdesinë ndaj të tjerëve, lakminë, makutërinë e vese të tjera dëmprurëse dhe ngre e vlerëson lart virtytet si domosdoshmëri për mbarëvajtjen dhe mirëqënien e shoqërisë njerëzore.

Vepra «Jusufi e Zulejhaja» në tërësi «dëshmon për një pjekuri më të madhe» të Muhamet Çamit si vjershëtar; ndonëse në të s'vërehet shtjellimi «dramatik i Ervehesë», po bie në sy dukshëm një mjeshtëri më e madhe përshkrimi e analize psikologjike».[1] Duke u mbështetur në këtë mendim, disa nga shqyrtuesit e veprave të Muhamet Çamit thonë se «Jusufi e Zulejhaja» është punimi i fundit i

1) Historia e letërsisë shqipe, V. I. Pj. II. Tiranë, 1959, fq. 292.

jetës së tij; një gjykim i tillë s'ka arsye të plotë për t'u pranuar, sepse dihet që s'janë të pakta rastet edhe në ditët e sotme që një penëpërdorues pas një vepre të rëndësishme në vend që të nxjerrë nga dora e vet një tjetër më të rëndësishme — siç pritej — ka nxjerrë një me më pak vlerë e ngandonjëherë edhe të dobët.

Vepra e vet dorës ende s'është gjetur; kopja e saj më e përafërt është ajo e shkruar nga konispoliti Shaban Xhafer Goxhai, në të cilën është shënuar data 28.8.1300 rumi (10.9.1884). Mbi një faqe të saj është derdhur ngjyrë shkrimi. Përveç 2432 vargjeve të Muhamet Çamit, në fund gjenden edhe 56 vargje të dobët, të shkruara prej këtij kopjuesi apo prej ndonjë parakopjuesi. Fletorja ku është kopjuar «Jusufi e Zulejhaja» ka qenë ruajtur ndërmjet librave të atdhetarit të mirënjohur konispolit, Shuaip Mahmud Musa Dalanit; më 1909 ajo u gjet atje prej Mehmet Muhamet Alushit po nga Konispoli, i cili e ruajti deri më 1949-50, kur ia dorëzoi shërnipit të Muhamet Çamit, Veip Haxhi Mehmet Fejzullahut (Veip Kuçukut) e ky ia dërgoi Institutit të Shkencave. Më 1957 e 1960 në Delvinë u gjetën edhe tri kopje të tjera; fjalori i përdorur në ato kopje s'përkon plotësisht me kopjen e shkruar nga Shaban Goxhai, sepse ndikohet mjaft nga e folmja labe. Po dubet thënë se edhe fjalori i përdorur nga Shaban Goxhai ka plot shmangie nga fjalori i mirëfilltë cam jo vetëm i kohës së Muhamet Çamit, që po se po, por edhe nga ai i ditëve tona.

«Jusufi e Zulejhaja» — si edhe tërë veprat e

tjera të Muhamet Çamit — është shkruar shqip me njëlloj abeceje të përbërë prej shenjash të elifbeve arabe, osmane e persiane.[1] Kështu që, me tërë përpjekjet, vëmendjen dhe kujdesin që i kushtoi Muhamet Çami shqiptimit të përpiktë të fjalës, prapseprapë ajo e shkruar me atë lloj abeceje shpesh paraqitet si një grumbull bashkëtingëlloresh, e palexueshme si duhet prej atij që s'e din. Gjatë rishkrimit me abecenë e sotme, nuk u cënua aspak ndërtimi i vargjeve apo fjalori i përdorur në to; vetëm se, për të qëndruar brenda 8-rrokshit, në disa vargje që dilnin jashtë tij ndonjëherë — aty ku nuk prishej bukuria e rrjedhshmëria — u zëvendësua gërma (krye sisht zanore) me një theks. Kur një gjë e tillë që e pamundur, vargu u la sërish siç ishte.

Data e lindjes e datëvdekja e Muhamet Çamit nuk dihen me përpikëri. Osman Muderrizi, i cili e përdori dhe e bëri të njohur të parën herë veprën e Muhamet Çamit — shënon se lindi në vitin hixhri 1197 (1782-83);[2] në «Historia e letërsisë shqipe» thuhet se lindi më 1784 dhe vdiq në vitin hixhri 1260 (1844)[3]. Po këtë vit vdekjeje shënojnë edhe Aleksandër Xhuvani, Mahir Domi e Osman Mude-

1) Ibrahim D. Doxha, «Nëpër udhën e penës shqiptare», Tiranë, 1982, fq. 82-85.
2) Buletini i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1951, fq 75.
3) Historia e letërsisë shqipe V. I, pj. II, Tiranë, 1959, fq. 203, 204.

rrizi.[1] Në «Antologjia e letërsisë shqipe për shkollat e mesme» thuhet se lindi më 1783.[2] Në «Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe» thuhet se lindi më 1780 dhe vdiq më 1843.[3] Kurse Mehmet Alushi, nxënës i nxënësve të Muhamet Çamit, përdorues dhe ruajtës i disa veprave të tij, shënon se vjershëtari në fjalë lindi në vitin hixhri 1174 (1758-59) dhe vdiq në vitin hixhri 1242 (1826-27), në moshën 68 vjeçare.[4] Njëfarë mbështetjeje në vërtetim të kësaj fundshmie përbën edhe kopjimi i «Ervehesë» nga mulla Sulejman Omer Kuçuku në vitin hixhri 1245 (1829-30). Duket se kopjimi u bë edhe në përkujtim të Muhamet Çamit, edhe pse kërkesat për veprat e tij pas vdekjes ishin shtuar. Nëse Muhamet Çami atëherë ishte gjallë, vetëkuptohet se s'kishte se përse vepra e tij të kopjohej nga i kushëriri i vet.

Muhamet Çami doli nga gjiri i Kuçukëve, banorë të lagjes «Çuçat», lagjja më e madhe dhe më

1) Aleksandër Xhuvani e Mahir Domi, «Muhamet Çami», dorëshkrim, Fondi i Arkivit të Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë së Akademisë së Shkencave, dosje nr. 652.
2) Antologjia e letërsisë shqipe për shkollat e mesme, Tiranë, 1958, fq. 501.
3) Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe, Tiranë, 1952, fq. 64.
4) Mehmet Muhamet Alushi, letër më dt. 8.I.1977. Fondi i Shtëpisë Botuese Vetjake «Hasan Tahsini»; dosja «Muhamet Çami».

e rëndësishme e Konispolit; për rritjen dhe shkollimin e tij u kujdes i ungji, Omeri, sepse i ati i tij, Hamzai, e la bonjak që të vogël. Pasi mori mësimet e para për 4 vjet në meqtep dhe të dytat për 6 vjet në medresenë e Konispolit, u dërgua në medresenë e lartë «Al Az'har» në Kajro, sepse Egjipti atëherë sundohej nga Mehmet-Ali pasha Kavalla prej Opari dhe Jugu Shqiptar nga Ali Pasha Tepelena. Duke u mbështetur në atë që sundimtari i pashallëkut gati gjysëm të pavarur të Janinës kujdesej drejtpërdrejt vet për pajisjen me dije të larta të bashkatdhetarëve të shtetit të qeverisur prej tij — siç është rasti i mirënjohur i dr. Vangjel Meksit — ka të ngjarë që edhe dërgimi i Muhamet Çamit në Egjipt dhe mbajtja atje për aq vjet të jenë bërë me porosi dhe ndihmë financiare të Ali p. Tepelenës. Besimi mbi sa u tha bëhet edhe më bindës, po të mbahet parasysh se Omer Kuçuku — ndoshta edhe tërë Kuçukanjt e tjerë — ishte një nga pjesëtarët kryesorë më të zjarrtë (sikur edhe vet Muhamet Çami) i palës konispolite përkrahëse e Ali p. Tepelenës.

Mësimet e larta në Kajro Muhamet Çami i kreu gjatë 11 vjetëve të qëndrimit të tij atje; me t'i mbaruar ato, ai u kthye menjëherë në vendlindje; meë prirej vendosmërisht nga bindja se prej dijeve të veta mund dhe duhej të përfitonin edhe bashkëvendësit e tij të pashkolluar dhe, meqë nga ana ekonomike s'e «shtrëngonte këpuca», u muarr me thellimin e mëtejshëm të dijeve, me përkthime, me përshtatje e me rikrijime; njëkohësisht u muarr edhe me shërbime fetare në xhami dhe jashtë saj

si edhe me mësimdhënie në medrese, po gjithmonë e gjithçka falas.[1] Puna e tij e pandërprerë dha plot vepra në gjuhën shqipe nga të cilat deri tani janë gjetur 17: 11 të shkruara e 6 të ruajtura vetëm në kujtesën e shërbimebërësve fetarë në xhamitë e Konispolit, Mehmet Alushi e Hajri Mehmet -Emin Muderrizi.[2] Po, meqë veprat e tij — kryesisht «Jusufi e Zulejhaja», «Herveheja», «Mevludi», «Binamazi» e «Risale-i Bergjevi»[3] — përdoreshin mbaras si lëndë mësimi në medresenë e Konispolit, nxënësit e saj i dinin përmendsh thuajse të gjitha; ndër të fundit e këtyre nxënësve kanë qenë edhe hafëz Mahmut Selimi (Peqini), hafëz Satedin Xhaferr Muderrizi, Shaban Aliu (nga Vërva) e shërbimbërës të tjerë fetarë të xhamive dhe të medresesë së Konispolit.

Gjatë 10-vjeçarëve që lindi e u rrit Muhamet Çami ndjenja kombëtare dhe lëvizja për mëvetësi e vetëqeverim rriteshin hovshëm nga dita në ditë,

1) Në mbarë Çamërinë — veçanërisht nëpër qytete dhe në fshatrat e mëdhenj — përveç shërbimekryesve fetarë rrogëtarë, ka patur tejtëhu edhe nga ata që në ditë të caktuara shërbenin falas, «për shpirt» — siç thuhej
2) Prej këtyre të dyve kam vjelur të 6 veprat e Muhamet Çamit të ruajtura vetëm gojarisht; veprat e shkruara s'dihet ç'u bënë.
3) Çdo vepër Muhamet Çami e mbyllte me një strofë ku shënonte emrin e tij dhe të atit, po jo mbiemrin. Mulla Duro Asqeriu meqë s'ia dinte rrënjën, përdori për mbiemër fjalën «Çami»; me këtë mbiemër ai u njoh më pastaj botërisht me rastin e botimit prej Jan Vretos të veprës «Erveheja».

gjë që u mishërua e u pasqyrua më së miri sidomos me ngritjen e vilajeteve-shtete gjysëm të pavarura të bushatasve në pjesën veriore të vendit dhe i Ali p. Tepelenës në pjesën jugore. Një gjendje e tillë s'kishte se si të mos shoqërohej edhe me një lëvizje të fuqishme në lëmin e penës e të dijeve shqiptare. Pikërisht gjatë 10-vjeçarëve të sapopërmendur vuri në veprim aftësitë e veta në lëmin e krijimtarisë shqiptare — kryesisht në atë të vjershëtarisë historike e shoqërore — edhe Muhamet Çami, «më i shquari i asaj periudhe».[1]

Në tërë veprimtarinë e vet Muhamet Çami u mbështet **në letërsinë arabo-osmano-persiane**; prej saj ai mori jo vetëm brumin për gatimin e veprave të veta, por edhe shenjat e shkrimit e mbi të gjitha alfshin dhe ndjenjat që përshkonin ato fund e krye. Ai zgjodhi pikërisht ato burime jo vetëm për shkak se i njihte mirë, por edhe pse zyrtarët osmanë atëherë s'linin në qarkullim letërsi tjetër, përveç asaj osmano-arabe-persiane. Megjithëkëtë, edhe pse ngjarjet i huazoi nga vende të tjera, ai bëri çmos për t'i «shqiptarizuar»,[2] për t'u dhënë atyre një ngjyrë të pëlqyeshme nga bashkatdhetarët e tij, t'i bënte sa më tërheqëse për ta, gjë që edhe ia arriti.

Muhamet Çami shquhet për njohuri të thella në lëmin e dijës shqiptare e ato të të huajve, ai da-

1) Historia e letërsisë shqipe V. I, pj. II, Tiranë, 1959, fq. 252.

2) Aleksandër Xhuvani e Mahir Domi, «Muhamet Çami», dorëshkrim; Fondi i Arkivit të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë së Akademisë Shkencave, dosje nr. 652.

llohet **si zotërues i përgatitur** mirë në lëmin letrar; kategoritë **gramatikore të shqipes i ka dalluar me përpikëri dhe i ka shkruar shkoqur.** Në vargjet e tij s'gjen kurrë 2-3 fjalë të shkruara tok.[1] Jo më kot ai parapëlqeu **vargun 8-rrokësh si masë** ndërlidhëse me gjindjen **gati tërësisht** të pashkolluar; kjo masë ishte **përdorur gjërësisht** në këngët popullore, sepse ishte **masë vargu e kapshme** me lehtësi prej bashkëvendësve **dhe mbarë bashkatdhetarët** e tjerë të tij.

«Jusufi e Zulejhaja» si edhe tërë veprat e tjera të Muhamet **Çamit shërbyen shumë si** në lëmin e atdhetarisë, **ashtu edhe në lëmin** e edukimit shoqëror. **Vlera e tyre është e dukshme** edhe në ditët e sotme.

Ibrahim D. Hoxha

1) Osman Muderrizi, «Jeta dhe vepra e Muhamet Çamit», dorëshkrim, FA të IGJL së ASHK, dos. 652.

JUSUFI E ZULEJHAJA

Me isti-ane të Hakut
bashlladisa një hiqaje
shqip, ta marrënë vesh hallku,
ta dëftojmë me një kajde.

Aj qerim, ibni qerim,
ibni qerim, ibni qerim,
aj Jusuf, ibni Jakup,
ibni Is-hak, ibni Ibrahim.

Kur erdhi Jusufi ndë dunja,
ju dha meshhur bukurija,
Jakupi e kish ndë sevda,
s'e ndan hiç ga dashurija.

Kur vate trembëdhjetë vjet,
nurrë e ti shumë e çtoj,
i jati i bën muhabbet,
tjatrë si këtë nuk duaj.

Kish tamam dimbëdhjetë djelm,
ga gjashtë gra që kish marrë,
të gjithë meshhur ndë alem,
Rubili ish më i parë.

Dhe një natë gaha netë
Jusufi sheh nd'ëndërrimë
ile tamam njëmbëdhjetë,
hënë e diell ju zdriqnë.

Përpara ndë dhe i ranë,
pa sikur i bënë sexhde,
feksi dunjaja anë mb'anë,
kaq nur i madh ra mbi dhe.

Ndë vaktë seharit u zgjua,
babait ju bë ifade:
«Ç'do të jetë, as më thua,
pashë sikur ranë bi dhe.

Njëmbëdhjetë il të feksurë,
më ranë diell e hënë,
me shumë iqram të bukurë
të gjithë sexhde më bënë».

Dhe Jakupi u sillois,
i tha: «Kjo ishtë ilhami,
një e mirë për ti u nis,
të mos e marrë vesh njeri!

Se këtë, po ta digjojnë
të tjerëtë birazerë,
mirë do ta kupëtojnë,
haset i madh do t'u bjerë.

Se shejtani nuk qëndron,
vesvesetë s'i pret kurrë,
ga që t'u prishë vështon
me çdo hile të fshehurë.

Andaj mos dëfto, mor bir,
këtë ruja që ke parë».
Një ga një ja bë tabir,
kundrë i tha gjithë me radhë.

Tek binë këtë suhubet
i biri dhe me të jatnë,
i digjoi nan' e djelmet
gjithë fjalëtë që thanë.

Jakupi s'e kupëtoi,
që i mban vesh më një anë,
djelmet vate u dëftoi,
kundrë u bë tabir ruajnë.

Të gjitha ua dëftoi
se ç'digjoj atë sahat,
të gjitha se ç'kuvëndoi
Jusufi bashkë me të jat.

Dhe ata vetë e ksiqisnë
ëndërrënë që kish parë,
shumë tertip të lik risnë,
bënë tahmin për te vrarë.

Thanë: «Babai s'na vështon;
sa të ketë këtë djalë,
me një tertip ta pastrojmë,
të mos t'e lëmë të gjallë.

Se, si ta presë umidhë,
Jusufnë të mos t'e ketë,
tjatërë s'ka se ç'të bnjë,
do s'do, nevet do na detë.

Se këtë na po t'e lëmë,
të mos i bimë çarenë,
babai e lë në këmbë,
pa hise do na kërrejë!»

Thotë një: «ishtë hata,
çish të vrasëmë vëllanë?
Ndë këtë u s'kam riza,
çish të bëmë hasëm babanë...?»

Të tjerëtë birazerë
i thanë: «Pse u qotepse?
Të vrasëm këtë një herë,
pra pastaj bimë tobe!

Port' e tobes ishtë açik,
lutemi më Perëndinë,
mos na prish këtë tertip,
se ki na humbi timinë».

Kaqë dit po kuvëndojnë,
fjalënë qish t'e ujdisnë,
me qish tertip të punojnë,
të vëllanë t'e humbisnë.

Më ndë bisht i dhanë karar:
«Ne të gënjejmë babanë,
t'i thomi që isht behar,
lëna një ditë t'e marrëmë.

Të vinjë me ne një ditë,
pra na ja bëjmë hizmetnë,
të vijë të hapë sitë,
të bëjë sehir bakçenë».

Shejtani u erdh galip,
mbi këtë karar e lanë,
të gjithë e panë munasip,
që të vrinë të vëllanë.

Jakupit i binë rixha,
«Të na japiçë Jusufnë,
se dhe ne e kemi vlla,
gëzojmë t'e kemi pranë».

Jakupi u sillois:
«Kam parë frikë ndë gjumë,
u nd' atë punë s'kuturis;
ta lëshoj jashtë Jusufnë...!»

Se kish parë ndë ruja
dhjetë ujq të mëdhinj shumë;
pas vetiut kish një manar,
ulqitë erdhë ja zunë.

Ja rrëmbienë ndë grikë
edhe e muarrë e vanë,
ga ajo ruja ka frikë,
se vinë ulqit ja hanë.

I thanë: «T'e marrëm tahud,
q'ashtu gjë të mos pësojë,
na ga asllanë, ga ulq,
ga të gjithë e shpëtojmë!

Po le të vijë, të vemi,
të binjë sehir bahçenë;
dhe na me të bashkë jemi,
po le të hajë dhe pemë».

Dhe Jusufi i digjoi,
deshi të vi me ta bashkë,
vetë iznë i kërkoi,
të gjesdisë vreshtavet jashtë.

I bën rixha dike qarë:
«Am iznë të vete dhe u,
të vete në vësht, në arë!»
Vetë mëndenë ja ktheu,

Ahdnë ua dha pas jacisë:
«E mirri», bëri xhevap;
gjene natënë noisi,
u sëkëlldis pa hesap.

Pa shih Allahu ç'punon,
s'e gjën njeriu me fiqir,
Jusufi atë natë gëzon,
s'di ç'bën Allahu takdir.

Jakupi po silloisej
dhe u bë shumë vesvese,
Jusufi me gaz ormisej
të vi me shokë ndë bakshe.

Dhe këta më tjatrë anë,
binë tertipe të mëdha
për të vrarë të vëllanë,
të mos të betej ndë dunja.

Jusufi sillois xhumbushnë,
i këcen kurmi përpjetë,
Jakupi vështon Jusufnë,
i binë lotë mbë dhetë.

Natën, sa u bë sabah,
lutej Zotit dike qarë:
«Bëmë derman shpejt, ja Allah»,
e shih që ish për të ndarë!

Lotë i derdh posi vardhanë,
që ga zemra sherëtin,
sillois atë ruajnë,
nuk i bën zëmrá qëndrim.

Kur e di që u hap dita,
djeltë i bë tembih me porsi,
hajvanë e zu ga kapistra,
u tha t'e hiqnë me lloi.

«Shini se mos gremisetë,
se nukë di të qëndrojë,
edhe bukë s'merr dot vetë,
t'i ipni, kur të kërkojë».

Djelt' e ti shum' i porositi,
Jusufnë puthi ndë ballë,
lotë i derdh pikë-pikë:
«Hajdeni, u qoftë mbarë...!»

Nd'anë Qenanit u ndanë,
djeltë zunë udhën e iknë.
«Hiç mos bën qeder! — i thanë,
bara me qindi do vimë».

Jakupi, sa vate drekë,
vështon djeltë e qan me lot,
më tjatrë anë dhe djeltë,
sa të vinë, s'drojnë dot.

Venë nd'arë ndë një hije,
që kish dhe një pus me ujë,
Jusufi tha: «Do të bije
të flë pak, se më vjen gjumë».

Shejtani u riu ndë grikë,
sa të fli një çik s'e prinë,
deshnë t'e therë me thikë,
të gjallë ndë dhe ta vinë.

Djali i madh brriti: «Medet,
qish të vrasëmë vëllanë,
me të tilinë ezijet
qish do t'ja marrëmë xhanë...?»

Shejtani i kalli ndë hased,
që t'e mbulojnë me gurë,
me të tilin ezijet
hasmi hasmin s'e vret kurrë.

«Ndë doi për të humburë,
bëni sabër pak e pritni,
se këtu jemi ndë udhë,
na shohënë, mos e vrini!»

Nefsi gjithnjë po i shtin:
«Ç'pritni e përse s'e vrini,
xhanë t'ja mirri me mundim,
se shpëtim ga ki ju s'kini..!»

Si u mbajtnë e s'e vranë
dhe ata prapë u mblodhë,
nd'atë pus që kishnë pranë,
të gjallë vanë e hodhë

Gjithë bashkë e kishnë zënë,
dike hequr xarrë-xarrë,
të madh të rrahur' i bënë,
mishtë e ti ja kishnë çarë.

Jusufi po i kthen sitë,
të vëllezërit vështon,
lotë i derdh pikë-pikë,
se e pa që nuk shpëton.

Zuri e brriti: «Aman,
pse më vrini, ç'u kam bërë?
Dhe u një gaha ju jam,
haka ime do t'u zërë...!

Pse s'e kujtoni babanë,
dolli vetë u porsiti,
se u s'ua kam takanë,
babai kështu s'e diti...?!»

Jusufi një copë diell,
tek qëndroj, feksi mejdanë,
posi iletë ndë qiell,
të bukur e kish surranë.

Vetullat akrep sahati,
të di sitë të zi pisë,
si dielli i feks surrati,
vet Zoti e kish stolisë.

Të dhjetë bashkë u mblodhë
edhe rrobatë ja qitnë,
mu ndë pus vanë e hodhë,
e lanë të gjallë e ikrë.

Kur ra, u përpoq ndë gurë,
u vra, pa brriti «Allah»,
e çveshnë, e bënë lëkurë,
feksi si illi në sabah.

Mbi drrasë gjeti nihajet,
se pusi ujë shumë s'pat.
ga Allahu kërkon medet,
i dhëmin plagët që pat.

Sa hasheratë të gjallë
ne pusi që kishnë folenë,
gjithë i vështojnë xhemalë,
u qasnë, i puthnë dhenë.

Zoti u dërgoj haberrë
atje tek po fillon natë.
«Do dërgoj një pejgamber,
azap u bi, po e ngatë!»

Të gjithë ita-at i bëjnë,
me shumë iqram e presnë,
bullari deshi për t'e grënë,
sa bën kast, po nuk e lënë.

Xhebraili vate e priti,
ga veshëtë e shurdhoi
dhe të di sitë ja qiti,
gaha të di e verboi.

Vetëm ndënji atë natë,
sa erdhi vakt' i suhurit,
shumë i dhëmin plagëtë,
që i kish vrarë nëpër gurët.

Atëherë Xhebraili
i tha: «Gre duart' bën amin,
të bimë tek Zoti dua,
inshallah të bën shërim...!»

Muxhize ga ai Zat,
kur vjen vakt' i suhurit.
xhdo i sëmurë gjën rehat
ga duaj' i ati nurit.

Djelt' e Jakupit u kthenë.
të vinë gjënë ndë jatak,
zunë ca zoq e i prenë,
këmishët ja bënë me gjak.

Mahsus i zunë' i prenë.
të vinë gjak ndë këmishë,
të binë vukuf Jakupnë,
ndonjë qërtim të mos kenë.

E bënë mushaverenë,
t'i themi: «Ulku e mori,
kurmnë copa ja preu,
gaha këmisha e nxorri».

Prej shtëpisë kur u kthenë,
zunë brrmën e bërrtitnë,
Jakupi me validenë
shpejt duallë e i pritnë.

Ju afëruanë fshatit,
binë një brrimë të ligë,
duallë gjithë xhema-ati,
të gjithë muarrë frikë.

Thanë: «Ç'ishtë këjo brrimë
që bënetë nd'atë anë...?
Qenanejtë tëhu vinë,
ca këmishë me gjak kanë».

Dhe Jakupi e digjoi,
e mori vesh atëherë
edhe vetë e kupëtoi
që ati i vinë në derë.

Erdhë djeltë, i pieti,
u tha: Çish kini që qani?»
«Jusufnë ulqit e prenë,
ja dhe këmishën» — i thanë.

U tha: «Kështu do mos jetë,
çish e ha ulku insanë...?
Ju si, çish ja bëtë vetë,
se mbajtëtë vesh shejtanë...!»

Mbet suqut, bëri teesuf,
lotë i derdhi posi krua,
se çish të bën, u mendua,
ndë jatak ra, u bulua.

Me këmishë fshin surratnë,
e vë ndë hundë, i mirr erë,
u tha: «Jargëtë ku janë,
kur e preu që e friti...?

Ulqit e kanë adet,
ndonjë gjë kur do t'e hanë,
jargëtë krua u venë,
që e qelbinë insanë...!»

I thanë: «ti s'na beson,
që ne të jemi të drejtë,
këmishën pse s'e vështon,
sos e kemi grënë vetë?»

Gjithë natën po rëkon,
se ju dogj brënda mëlçija,
me pahir bën sabër, duron,
ish kadër ga Perëndija...

Në sabah i foli djeltë,
zuri i bën istintak:
«Kur e zu ulku, ku jeshtë,
afër u ndodhtë a lark?»

«Na keshëm zënë e këcejmë,
në çapet kush hidhesh shumë,
nuk i pamë gaha erdhë,
sa ulq ishnë e çish e zunë.

Kur brriti, që e digjuamë,
të gjithë u kthem' me të parë,
ndë harca vam' vështuamë,
ca pika gjak kishnë rarë.

Shpejt muarrmë për ga prroi,
e pamë që e kish zënë,
këmishën e ti lëshoi,
ca mish e mori në dhëmë».

«Këjo s'munt të jetë e drejtë,
sos u hap dheu e hiri,
ju jeshtë bashkë të dhjetë,
gaha erdhi ua mori...?

Nefsi juaj u gënjeu,
bëtë një punë të ligë,
gaha e drejta u ktheu,
ga Allahu s'patë frikë...!

Po hajde të më dëftoni,
Jusufnë se ku e latë,
ndë e vratë vet, as më thoi,
gaha haseti që patë?»

U nisnë të gjithë e vanë,
Jakupi edhe me djeltë,
e shpunë, i diftojnë gjaknë
që kishnë hedhë atjetë.

U tha: «Këta s'ka të gjarë
dhe nuk ishtë gjak njeriu,
po ju vetë e keni vrarë,
shejtani në bark u riu».

I thanë: «Ti s'na beson
ga muhabeti që pate,
ajo mënde të mundon,
zë e na dëfton inate.

Çish do vrasëmë vëllanë
pa ndonjë faj fëjierë?
Zoti na e bën xhezanë
edhe ti e merr haberë!»

Xhevapet ua digjoi,
kundrë fjalëtë që thanë,
gjene ki nuk i besoi,
u hoq e ndënji mënjanë.

Vetëm rri, zuri e qan,
lotë i derdh radhë-radhë,
«Ja Rab, të ma biç bejan,
gjallë ishtë a e kanë vrarë?»

Ulqet u bë munada,
të gjithë i bënë ita-at,
«Më hëngrët Jusufnë, u tha,
Zotit do t'ipni xhevap!»

Të gjithë ulqit i thanë:
«Na këtë nukë e bimë,
as na, as shokëtë tanë
këtë haber nuk e dimë.

Ne Jusufnë nuk e pamë,
të qeshnë ata që të thanë,
mishtë tuaj ishtë harram,
të vijë ndë barqe tanë.

Ne për gjithë enbija
u bënemi hizmeqarë,
të binë tek Zoti rixha
ndë gazep të mos na marrë».

U tha: «Hajdeni ndë uratë,
se më foltë me të drejtë,
u e paçë që atë natë
që po ma punojnë djeltë.»

U kthe prapë prej shtëpisë,
i prit lotë me këmishë,
më s'i mbet, mënde në krije,
se tha: «Do ta kenë prishë».

Kaqë fort ju ngre rehati
në i hahej, në i pihej,
ju prish hatëri që pati,
gjumi natënë s'i flihej.

Dhe Azrailë e pjeti,
i tha: «Mos je pjekë vallë?
Djalënë tim se ç'e gjeti,
vdekur ishtë apo i gjallë?»

Azraili i dha xhevap:
«U shpirtinë s'ja kam marrë,
këtë punë ta diç mutllak,
që Jusufi ishtë i gjallë.»

Pastaj u bë perishan,
silloisej natë, ditë,
për Jusufnë gjithnjë qan,
sa ju veshnë të di sitë.

Jusufi në pus rënkon,
ga Allahu kërkon medet,
«Ah, babaj të më dëgjon,
gjene më nxjerr ndë selamet!»

Ndë një dërrasë qëndroi,
sa i vanë qiraxhitë,
tri dit' e di net duroi,
ga lotë s'ju terë sitë.

Arritnë dhe qiraxhitë,
kishnë dalë ga Medjeni[1]
për ndë Misir ishnë nisë,
thanë: «Këtu të dihemi».

I shkarkuanë devetë,
për nde pusi nisnë sakatë,
duajnë ujë me të shpejtë,
di bashkë u nisn' e vanë.

Ata ndë pusi që vanë,
se ç'kish brënda nukë dinë,
barkaçin e lëshuanë,
të mirrë ujë të pinë.

Goditi ndë fund të pusit,
litarija u trazua,
se ju rrëmbie Jusufi,
s'mund ta nxjerrë, se u rëndua.

1) Medineja

Kur e nxorri, u gëzua,
tha që «Tani kazandisa,
bahti ma kërreu mua
këtë skllaf që e pohtisa.»

Edhe shokut ti i foli,
e porsiti menjëherë;
«Mos thuaj nde pusi dolli,
po thuaj e kemi blerë».

E muarrë q'atë ditë,
ndë Misir vanë e shpunë,
e nxuarrë për të shitë,
njëzet grosh fiat i vunë.

Sado të mirrë, u vjen hosh,
«Teslim» thanë me të parë,
e shitnë tamam njëzet grosh,
nuk e përpoqnë pazarë.

Dhe tixhari, kur e mori,
e nxorri te shit ndë pazar,
burr'i Zulejhasë e mori,
floritë i zigjas me kandar.

Emrin e thoshnë Katfir,
e kish hazinë Rrejanë,
zabit mesh-hur ndë Misir
e bleu Jusuf Qenanë.

Poq e shpuri ndë shtëpi,
e porsiti Zulejhanë:
«Këtë skllaf t'e keç me timi,
pa t'i shohëm hakikanë.

Sikundër ka bukurinë
edhe ndë bojë qemalë,
shkojmë me të pleqërinë,
u thom që t'e bimë djalë...

U sikundrë i shoh fiqirrë,
ndë pastë dhe hakikanë,
do të na ketë më mirë,
gaha evlati babanë.»

Dhe Zulejhaja e blejti,
me shumë timi e priti,
ndë shtëpi brënda e mbajti,
rrobatë ja përtëriti.

Shumë zeman mbi këtë hal,
Jusufnë e jerleshtisi,
sa që arriti në qemal,
tridhjetë vjet i bitisi.

Që ndë sabah e ndë drekë
rri brënda vështon hizmetnë,
ndë vapë gjezdis bakçenë,
vi e qan ndënë një pemë.

Erënë që frin ga deti,
që stolis gjithë dunjanë,
e vi ndë be gaha ditë:
«Të më piqeç me babanë!

T'i thuaç mahsus selam
dhe i puth dorë e këmë,
thuaj: «E kanë shitë skllaf,
ndë Misir e kanë shpënë...»

«Kush e shiti?» — ndë të pjetë,
thuaj haberrë ta marrë,
që ndë pus e hodhë djeltë,
e nxuarr ca pramatarë.

E muarrë qiraxhitë,
ndë Misir e bënë mezat,
për pak grosh e kanë shitë,
njëzet grosh i vunë fiat.»

Pem' e qederit i foli,
tek vi e qan gaha zjarri,
ga akrabaja që dolli
që u ndanë për së gjalli.

Zulejhaja e pieti,
i thosh: «Pa dëftomë mua,
kaqë qeder pse të mbiti,
ç'të dhëm, të marrëm jatrua?»

«U të ligë nukë kam,
jatroi s'më bën dot hallë,
më vjen shumë zjarr për vatan,
që u ndaçë ndë të gjallë..:!»

«Sit' e tu që po kullojnë
lotë si margaritarë,
ndë zëmërë më pikojnë
më djegnë posi zjarrë..:!

Ti të mirë e ke rehatnë,
me të ngrënë e me të pirë,
po eja bën def meraknë,
se më vjen dhe mua mirë!»

«Dhe u dua ta mërgoj,
po më farmëkosi malli,
gaha kjo s'mund të duroj,
se jam ndarë për së gjalli...!

Shejtani ashtu punoi,
që na riu anamesa,
vëllezërit e mi mësoi
e bënë si s'jua ip besa..:»

Me atë të ligë që pësoi,
hiç nuk u prrish ndë fitirë,
nurr' e ti shumë e çtoi
ditë më ditë më mirë.

Kaqë nur që i kish hipë,
që shahtisej kasabaja,
kur shkon sokakut, bën dritë,
s'e li të dil Zulejhaja.

Zulejhaja q'atë ditë
që i pa proto xhemalë,
sevdaja e kish goditë,
burri e duaj për djalë.

Jusufnë e vështon ndë surrat,
po Jusufi s'i kthen sitë,
kjo ga sevdaja që pat,
e mba brënda natë, ditë.

Se burrën e kish sakat,
që s'vi dot te Zulejhaja
si e shih, erdhi ndë qemal,
mbi gjithë pëlset nga sevdaja.

Ga dashurija që pati,
u bë posi dru e thatë,
ju pre fitirë e takati,
s'e zi gjumi ditë, natë.

Kaqë kohë çish duroi,

që e kish Jusufnë pranë,
posi qiriu kulloi,
që digjetë ndë shandanë.

Skllava e saj e kupëtoi
sevdanë që i kish rarë,
gjene dhe vet i dëftoi:
«Më dogj sevdaja kufarë...»

I tha: «Pa vështo, një ditë
fole vetëmë ndë odë,
ndë i ktheftë nga ti sitë,
të do, po nukë të thotë.

Krietë ndë mos e ktheftë
gaha ti të të vështojë,
thuaja me gojë vetë,
do s'do do të të digjojë.

Dhe në mos dashtë ta bijë,
të kthenetë për të dalë,
nesër gjene do të vijë,
e ujdis dalë ga dalë».

Zulejhaja zu e shtroi,
odënë e nasqirisi
dhe Jusufit i dërgoi
vetëhenë shumë e stolisi.

Vate qëndëroj ndë këmë
ndë derë, që kish adetnë,
i tha: «Çish ke për të thënë,
thuajmë të bi hizmetnë!»

«Pa ngre sitë e vështomë,
s'të kam të më biç hizmetnë,
hajde të biem' ndë stromë,
bitismë qejfnë, haxhetnë!

Sit' e tu që s'më vështojnë,
që i kthen e vështon dhenë,
ndë zëmërë më pikojnë,
zoinë time ma prenë.

Dhe për ti, si isht' adeti,
që të më thoshe ti mua,
tani më sabër s'më mbeti,
të të them u që jam grua.

Jo që u jam zonja jote,
dhe të jeshë ndë mëhalllë,
hatërë do m'e vështoje,
vetë do m'e qaje hallë.

Kam tamam trembëdhjetë vjet
që m'ishtë prerë takati,
xhani për ti më digjetë,
m'u gre huzuri e rehati.

Pa vështo ndër këtë stromë,
mbëuarrë me çarçafë,
ndë daç fjalënë digjomë,
mos na merr të divet ndë qafë.

Ndë mos digjon me rixha,
ndrishe do t'e keç hesapnë,
se s'u bëçë më për dunja,
po do të bi telef xhanë.

As më thua, pse e mbodhis,
pse s'e bën shpejt këtë punë,
gaha se nuk kuturis,
tahut gjithë t'i marr unë!

Ndë trëmej ga burri im,
e farmakos e shpëtojmë,
gjëja, tuk isht malli im,
të bimë qejf sa të rrojmë!»

«U ga burri it frikë s'kam,
gaha tjatrë njeri s'trëmem,
po kjo punë isht harram,
ási Allahut s'i bënem.

Jo që kam grënë e kam pirë,
kam bërë shumë rehate,
gaha një evlat më mirë,
afërë ndë masllahate.

Po, të jesh edhe i largë,
si trëmem ga Perëndija,
nukë keshë për të vatë,
se s'ma jep besë e Turqija.

Si, çish t'i qepem gjunahut,
të mos sillois azapnë,
u, gon' i Halil-ullahut,
turpëroj gjishn' e babanë!?

Dej, ditën e aresatit,
ga buluk i enbijavet,
dal jashtë ga xhema-ati,
mbetem me të xhuheavet.»

«Del silloisu një çikë,
mbëlidh mënden e fiqirë,
pse t'u dukçë kaq e ligë,
ku do të gjëç më të mirë?

Të kërkoç gjithë Misirë,
fshatërat e kasabanë,
nukë gjën dot më të mirë
tjatërë si Zulejhanë!»

Kaq dit'e bëri davet,
Jusufit s'ju kthe fiqiri,
si s'i bëri ixhabet,
gjene skllavenë e thiri.

«Tertipnë që më dëftove,
si më the, ashtu e nisa,
i thaçë kundrë më mësove,
laqin dot nuk e ujdisa.

Gjene dhe tani dorë s'heq,
se jam djegë, si të thaçë
ta mërgoj, bënem më keq,
ai s'do sikundrë e paçë.»

«Me se ta gjeti çerpinë
që s'e merr sevdaja xarrë?
Gaha ti që s'e kthen sinë,
andaj s'të bënetë barrë.

I tha: «Të dërtoç një odë.
Stismatë gjithë me pasqirë,
gahado që të vështojë,
të sheh surratnë fort mirë!»

Shpejt ustallarëtë i foli:
«Dusheme dhe me tavanë
me qelqe të ma dërtoni,
pasqirë, të shoh surratnë»

Kaqë dit sa e bitisnë,
gjithënjë e vjas ustanë,
sikundrë u tha, e ormisnë,
pasqirë më të gjithë anë.

E foli Jusufnë brënda,
riu, qëndëroj ndë këmbë,
i tha: «Të viç gaha prëma,
ndë këtë odë të flëmë!»

Vështoj më të gjithë anë,
tjatërë s'i shihnë sitë,
vetëmë shih Zulejhanë,
diertë i kishnë mbillë.

«Aman more, të kam rixha,
buza jote si jakuti,
s'më lë të rroj më në dunja,
këmbë, duar m'i këputi.

Faqet e tua si mollë,
dhëmbët posi gur' elmas,
më mirë vramë me dorë,
ga sevdaja të mos plas!

Të preva rroba të mira,
hazër t'i kam ormisurë,
stromëtë me rodhërira
për ti i kam duzdisurë.

Aman, për ashk të Perëndisë,
kujto aresat mejdanë,
vërmë dorënë ndë sisë,
se më përvëlove xhanë!

Në trëmbej gaha gjunahu,
kam u mall sa që të dua,
bënetë razi Allahu,
më bën hatërë dhe mua».

Jusufi i jep hevap:
«Këto leshërat e mija,
ç'më kërkon nefsi, t'i jap,
m'i prish vetë Perëndija.

Boja ime kaq e fortë
edhe këjo bukurija,
kur të vdes, të hi ndë botë,
t'i shoç, të merr nagulija.

Kurmi im me kaq duzen,
i helqurë si llastari,
ta shoç, për të vjellë të vjen,
kur të zërë krrimba varri.

Eja e kujto mahsherrë,
që do grehetë divanë,
të gjitha, turpe e ndere
atje marrënë mejdanë.»

Jusufi i ip xhevap,
me frikë të ahiretit,
të kujtonej për azap,
të hiq dorë nga shehveti.

Zulejhaja nuk digjon,
i digjej brënda kufari
dhe azapë nuk kujton,
nuk merr vesh hiç gaha zjarri.

S'kujton ahiretnë e varrë,
si i kish marrë vuxhutnë,
i tha: «S'ka tjatërë fjalë,
po do t'e shoç këtë punë!»

Si e pa dhe Zulejhaja,
që s'e kish atë fiqir,
s'duroj dot gaha sevdaja,
vate t'e zi me pahir.

«Vetëhenë e gjënë e prisha,
çish vështon të dalç në derë?»
E zu pas gaha këmisha:
«Do viç me pahir njëherë!»

Jusufi ish më i fortë,
u hoq e mori divanë,
tek vate të dil ndë portë,
jatosi u poq me aganë.

Me të parë Zulejhanë,
që vi pas Jusuf Qenanit,
pjeti: «Këta çish kanë,
që gushepsenë divanit?»

Zulejhaja ga inati
Jusufit i vu iftira,
ashtu i tha taksirati,
ajo ishtë adet ndë gra.

Burrën' e saj zu e qërton:
«Ç'ishtë ki skllaf që më solle?
Më zu të më turpëron,
ishtë hajdut, s'ishtë qole?!

Tek rrinjë, jeshë kumbisë,
ki erdhi, m'u afërua,
më hodh dorënë ndë sisë,
me pahir më duaj grua.

Ç'do të jetë këjo punë,
gjithë skllevë kanë vuzeraja,
po s'i haptë sitë, thom unë,
bënetë harap dunjaja.

Ki të pësojë xhezanë,
gjithë alemi ta digjojnë,
skllevëtë gahado që janë,
si ki skllaf të mos punojnë.

Bëri të madh kabahet,
po që të mos mundonetë,
skllevëtë marrën ibret,
më xhdo vënd do të bënetë.»

Zulejhaja s'ndënji të prit,
që t'i thosh burri xhezanë,
u trëm mos duaj t'e vrit,
tha: «Ta hedhëmë ndë hapsanë!»

Jusufi nisi edhe qan:
«Eja e kujto Perëndinë,
mos më vurë këtë buhtan,
se ne s'bënemi hainë!

Këjo vetë më kërkoi,
pra u nuk i dhaçë riza,
çish thotë «Më turpëroi»,
ga inati flet iftira!

U kam borç me sheriat,
ti edhe gruasë sate
t'u bi hizmet me hakikat,
këjo mb'atë fjalë vate.

Po eja e bëne tahkik,
këjo punë po të jetë,
po ju qasçë me kast të lik,
të ma biç xhezanë vetë!

Më thotë: «Erzinë më prishe»,
këjo dërgoi e më mori,
këjo më zu prej këmishe,
pa vështo se si ma çorri!

U hoqa me forë e ika,
këjo më hiq prej jatakut,
s'e mbajta vesh gaha frika,
asi nuk i bënem Hakut».

Fjalëtë gjithë ua ndjeu,
ga të di gjithë me radhë,
s'mori vesh çili fëjeu,
të di dilë faqebardhë.

Azizi u bë hajran,
shum' e ligë punë i polli,
një sabi ndë djep ndë divan,
për Jusufnë shahit dolli.

I tha: «Vështo ndë këmishë,
përpara ndë ishtë çjerrë,
skllavi e ka dogëndisë,
ajo dreq ta dha haberrë.

Jahot pas ndë ju ka grisë,
bën terbije Zulejhanë,
ajo vetë e ka cingrisë,
skllavi dreq ta dha xhevapnë».

Azizi kur e digjoi,
u thjamaks ga martirija,
Zulejhanë e qërtoi,
ju bë ispat dashurija.

I thotë: «Hilet' e gravet
had, hesap nukë kanë,
u vënë buhtan enbijavet,
nuk e kujtojnë gjunahnë».

«U s'e kam bërë kabull,
kahpellëknë s'e kam pasë,
çish do kërkojë një kull,
s'e dojë, andaj t'e thaçë.

Dhe ti vetë mirë më di,
që s'jam ndë punë të ligë,
vajta kaqë kohë tek ti,
burrë s'kam parë as çikë.

Kam kaqë kohë që duroj,
s'të kam sjellë turpe kurrë,
thaçë të mos turpëroj,
kam duruarë për burrë.

U t'e kam mbajtë timinë,
sikundër ishtë iktizaja,
ti më garkon ligësinë,
ta marrënë vesh dunjaja.

Jusufnë po s'e bëre haps,
po s'i preve dhe xhezanë,
ja vetëhenë time do vras,
ja do iki të marr malë!»

U sillois dhe Katfiri,
tha: «Sa të prishem me grua,
të bi haps këtë më mirë,
se këjo punë u digjua».

E muarrë vesh dunjaja,
sikundër gjau vakija,
thoshnë: «Ç'bëri Zulejhaja...»,
e bijën gibet grarija.

Se gratë e kanë adet,
jo vetëmë Zulejhanë,
e kanë për bash zijafet
të përheqënë dunjanë.

Zulejhaja e mori vesh,
që përhiqej ndë sokak,
çilado që t'e shih, qesh,
s'e dijën që pati hakë.

Se qitapi na dëftoi,
çilido që qesh me botë,
dhe vetë do t'e pësojë
më shumë gaha ç'të thotë.

Jusufnë s'e kishnë parë,
s'ja dijën dhe bukurinë,
i tili nishan s'kish ardhë,
posi il ndë vetëtimë.

Jusufi ga bukurija,
nukë pati shok të ditë,
driton posi farfurija,
i feks ujëtë ndë grikë.

Kur dil në diell e qëndron,
gahado të kthen surratnë,
posi pasqirë të verbon,
shahtis të gjithë dunjanë.

Zulejhaja u pikua,
nukë fli as natë, as ditë,
posi qelës u kullua,
ju thanë brënda mëlshitë.

Kur Jusufi i dil karshi,
gjithë vuxhuti i djerson,
tek kthenej t'e vështon me si,
mu ndë zëmër i pikon.

Ndë zëmër i vjen një dallgë
si deti kur ka furtunë
dhe kur ish me shoqe bashkë,
mënden e kish më Jusufnë.

Gratë zunë e qesëndisnë,
e pikosnë Zulejhanë:
«Gruaja e azizit tënë
bëri maskara dunjanë...!»

Dhe Zulejhaja një ditë
gratë dërgoj e i ftoi,
ata që e qesëndisnë,
jatakët ua dërtoi.

Dhe Jusufnë e porsinë:
«Sot kemi pakëzë punë,
ca musafire na vinë,
po të viç të na japç ujë!».

Dizet gra ga parësija
i vanë të gjitha bashkë,
që ju mbush brënda shtëpija,
u kumbisnë ndë jatakë.

Jastëkët ua ujdisnë,
ndënjnë të gjitha me radhë,
mbi çiltera u kumbisnë,
kundr' ish adet ndë të parë.

Ga një portokall u dhanë,
ndë liba i kishnë ormisë,
të gjitha me thika pranë,
mahsus i kishnë trohisë.

Poqë i zunë me dorë
thikatë me portokalë,
Jusufit vanë i folë,
dolli si hëna ndë malë...

Kur e panë, u shahtisnë,
më nuk ditnë se ç'punojnë,
duart e tiret i prisnë,
edhe hiç s'e kupëtojnë.

U pikon gjaku ndë gjunjë,
kaq e humnë e vështojnë,
shpejt thikatë ua zunë,
gaha duartë ua hojnë.

Zulejhaja i pjeti gjithë:
«Pse vështuat e shahtistë,
duartë tuaja i pretë,
rrobatë me gjak i mbitë?!»

Kur vështuanë ndë duar,
me thika i kishën çarë,
sikur prisnë mish të huaj,
haberë s'e kishnë marrë.

Të dizeta që u prenë,
që të gjitha faj nuk panë,
ndë ato pesë veta qenë,
që e përhiqnë Zulejhanë.

Të pesa u bënë sebep,
që dërgoi e i ftoi,
i bënë duartë ibret,
u bënë për te jatroi.

Njëra ish e mabejnxhiut,
tjatëra ish e sakasë,
e treta ish e akçiut
që flit turpn' e Zulejhasë.

Dhe një ish e bulukbashit
që ish zabit ndë hapsanë,
edhe një tjatërë, pesë,
e përhiqnë Zulejhanë.

Një middet suqut u bënë,
s'folë dot gaha baldija,
kur mblodhë mëndtë ndë një,
shihnë duartë të dija,

që i prenë, i bënë keq
ga Jusufi që e panë,
binë be që ishtë meleq,
s'ka të gjarë ndë insanë.

Dhe Zulejhaja u thotë:
«E patë Jusuf Qenanë,
zem më bëtë ndëpër botë,
ja, tek ki keshë sevdanë.

U kaqë vjet' ditë, natë,
e keshë pranë vetiut,
ju, menjëherë që e patë,
atë çast lezet u riu.

Pse s'patë mënde në krie,
ju keshtë presa ndë duar,
ai shkoi ndëpër dier,
ju pretë vetëhenë tuaj!

Ndaj u thaçë, m'u pre gjaku,
kam vdekurë ndë të gjallë,
më këcen dallga ga barku
si tërmeti kur tunt malë.

U e mjera keshë hakë
që u thaçë si fotija,
më digjej kufari flakë,
ma di hallë Perëndija».

Dhe këto ja thanë llafnë:
«Burri pse s'u sillois?
Ti të ka marrë në qafë
dhe murati s't'u bitis.

Burri t'u ndoth ndë gaflet,
Jusufnë mos t'e kish marrë,
tani u bëre me ilet,
ta dogji brënda kufarrë...!»

Të gjitha sa gra që qenë,
të gjitha sevda i vunë,
gjithë vështojnë t'e kthejnë,
t'e kishnë brënda Jusufnë.

Dhan' e dhanë me hilera
t'e shpien Jusufnë pranë,
po aj s'digjon vesvesera,
se vështon din' e sheriatnë.

E panë që dot s'e kthejnë,
të gjitha bashkë u mblodhë,
Zulejhasë prapë i vanë,
Jusufnë brënda e folë.

Jusufnë e mbiti djersa,
kur e pa që e mbëllitnë,
tha me vetëhe: «Tani ndesa»,
se trëmej se mos e zinë.

I thanë: «Mba vesh tët zonjë,
ja, vështo si u kullua,
nuk të vë cita ndë thonjë,
çish i thoshe: «Nuk të dua...!?»

Natën, ndë vapë të veç,
t'i shtipç këmbëtë, t'e fërkoç,
jatrua vetë t'i bëneç,
ishtë sëmurë, t'e shëroç!

Ti na thua: «Jam sojli,
djalë oxhak ga Qenani,»
çish merr ndë qafë një njeri,
që për ti minj i del xhani...?

Na të themi me të mirë,
që të na digjoç rixhanë,
pastaj t'e diç me të dirë,
që do të veç ndë hapsanë.

Dhe ndë hapsanë që të veç,
s'na ke për të shpëtuarë,
rehat ga na do mos keç,
na s'të jemi për të ndarë.

Gjithavet na farmakosi
boja jote, bukurija,
kolli dhunet na shkarfosi,
na prishi gaha mëlshija.

Gjak s'na mbeti ndë damarë,
lezetetë na u grenë,
shkon posi zabit qibarë,
nuk e bejendis alemnë.

Gjithë ç'ditëm e ç'kujtuamë,
shumë kollaj ta thamë llafnë,
tani ga borxhi duallmë,
more vetëhenë ndë qafë!

Na s'të thamë «Bitu ndë lumë»,
që të humbeshe për jetë,
po të thamë për një punë,
që djelë e kërkojnë vetë.

Zulejhasë ja di hallë,
pse s'ja bëre def qederë
dhe ndëpër ne më të rrallë,
të na vinje ga njëherë?»

Jusufi s'ua digjoi,
po u lut te Perëndija:
«Ja Allah, ga u mërgoi,
t'u hiqetë dashurija!

Hapsana më vjen më mirë
ka këjo që më kërkojnë,
ja Rabi, nëmë hajrlinë,
ga këjo po më kërkojnë,

S'ju vete ndë atë punë,
që të bi si të më thenë,
do të ndahem me Jakupnë,
turpëroj suanë, xhednë...»

Si ua preu xhevapnë,
gjene të gjitha u grenë,
ndë mexhlis vanë u thanë:
«Pse s'kollandrisni ulqenë?

Skllav' i Zulejhasë hain,
zonjnë e ti bëri zem,
nuk i bëtë ndonjë mundim,
të marrën ibret ndë alem...!»

Mexhlisi karar i dhanë,
sikundër e kishnë adet,
për epizoi ndë hapsanë,
të mos dalë kurrë ebed.

Zulejhaja e digjoi
këtë karar që e dhanë,
bulukbashit i dërgoi
takëm të duzdis konaknë.

Konaknë brënda e shtroi
me qilimë, me halira
dhe akçinë e pagoi,
që t'i shpi fai të mira.

Porsiti dhe ndë hapsanë,
njeri të mos t'e mundonjë,
«Të ja ruani tabi-atnë,
të binjë si që të donjë!»

Dhe mexhlisi me xhurnale
nisnë zabitë të fortë,
«Shpejt, hajdi ta mirri xarrë,
shpirje ndë bodrum teposhtë!»

Ndë ato ditë bëri vakija:
akçinë edhe sakanë
i paguanë ehalia,
të farmakosjën Rrejanë.

Rrejan e thoshnë mbëretnë,
që ish mbëret ndë atë ditë,
e kish bezdisur ulqenë,
se i kish të liq zabitë.

Nuk u bë razi sakaja
të farmakosnjë mbëretnë,
akçiu mori paratë,
e bëri kabull rushvetnë.

Faitë i bë me farmak,
t'e farmakosë menjëherë,
poq i vate me çanak,
sakaja ja dha habere.

I tha: «Mos ha ga faija,
se të ka hedhë zeherë,
e paguan ehalija,
ta thaçë, t'e keçë haberë!»

Akçiu kur e digjoi,
që i dëftoi sakaja.
me të rreme ja garkoi,
t'i bënej ati xhezaja.

Edhe i thotë Rrejanit:
«E paçë me të di sitë,
që e nxorri ga havani,
i ka mbushë farfuritë.»

Dhe Rrejani u sillois,
s'e di se kujt t'i bën xhezanë,
që të di bashkë i nis,
i dërgoi ndë hapsanë.

Gjene nesëret i foli,
i dha sherbetnë sakasë,
e piu, nuk e dënoi,
shpëtoj, se thosh «Do më vrasë».

Dërgoi mori akçinë,
«Sakaja e piu vetë,
shko dhe ti të haç fainë,
ndë më fole me të drejtë».

Akçiu s'e afëroi,
e kish vetë kabahetnë,
gjene ndë haps i dërgoi,
sa ju nxuarrë hiletë.

Gjene nd'ato netë që vanë,
sakaja dhe me akçinë,
që të di ndë gjumë panë
halletë që do t'u vinë.

Nisi sakaja e dëfton
ëndërrënë që kish parë,
s'kish umidh që të shpëton,
të vi tek ish protoparë.

«Paçë sikur shtipnjë rrusht,
e hedhë në mastrapanë,
e shterë, e binjë musht,
qirasa me të sulltanë».

Tha edhe akçiu: «Kam parë,
sonde m'u bë n'ëndërrimë,
copa buke keshë marrë,
vinë zoqtë m'i mbëlidhë.

Bukënë e kesh mbi kriet,
me pahir, me zi e mbajë,
zoqtë më bijën ezijet,
mbi krie vijën ma hajnë».

Jusufit vanë i thanë:
«N'ëndërrimë kemi parë,
të na biç tabir rujanë,
të shohëmë çish do na dalë!»

Nisi Jusuf pejgamberi,
proto ndë din i bën davet,
«Do të dili ga qederi,
besoni Zotn' e vërtetë!»

Zu tabirë, u bën bejan:
«Ti akçi do të të nxjerrë,
do të varë ndë mejdan,
ta thaçë, ta keçë haberrë.

Kabaheti që punove,
tani xhezanë t'e prenë,
mbëretnë dot s'e helmove,
po sa vrave vetëhenë».

U kthe i thotë sakasë:
«Ti që qirase alemnë,
do dërgonjë të të flasë,
të veç të keçë hizmetnë.

Muhabeti it ju shtua,
do të të flasë sulltani,
po t'i thuaç dhe për mua,
të më nxerrë nga zëndani».

Si u tha, ashtu i gjeti,
akçinë atë ditë e varë,
sakanë e vuri mbreti,
atje tek ish protoparë.

Se kush të ketë hakikat,
të detë veli-nimetnë
dhe të heqë ezijet pak,
s'ja humb Allahu hizmetnë.

Sakaja dolli e shkoi,
zu punënë, masllahatnë,
se ç'i tha ki, e harroi,
shtatë vjet ndënj ndë hapsanë.

Sakaja u gre e dolli,
erdhi hazreti Xhebrail,
Jusufit shkoqur i foli:
«Ti keshe Allahnë veqil...,

Z'bëre mirë që porsite
sakanë të të shpëtonjë,
ta diç që këtu lathite,
ai s'mund të të lëshonjë!»

Dhe ki nisi me të qarë,
sa ju kullua vuxhuti,
lotë i derdh radhë-radhë,
edhe lutej tek Mabuti:

«Aman, Allah, bëmë derman,
ndë llatho q'e bëra vetë,
pra, të mbetem ndë zëndan,
të mos dal për gjitthë jetë?!»

I lutej Zotit çdo vakt,
i rridhë lotë ga sitë,
ga të di i vanë gjak,
dike qarë natë, ditë.

Erdhi hazret Xhebraili,
gaha Zoti vahj i pruri,
që u bë razi Xhelili:
«O Jusuf, t'u sos kusuri...!»

Gjene prapë Zulejhaja
z'duron dot gaha meraku,
gjithënjë qan ga sevdaja,
i del një flakë ga barku.

E foli hapsanexhinë:
«Nxirre njëherë ndë ditë,
të vinjë ndë kuruntinë,
sa t'i shoh surratn' e sitë...!»

Ditë më ditë e kërkon
Jusufnë ndë kuruntinë,
me dorë e nxjerr, ja dëfton
që t'i bën def sëkëlldinë.

Kështu e ka gjetë insanë,
kaqë kohë çallëstisi,
Jusufn' e hodh ndë hapsanë,
pastaje vetë noisi.

Se Jusufi faj nuk pat,
nuk i hiqej ga hismeti,
Zulejhaja s'pat hakikat,
ja bëri barrë shehveti.

Atëherë ndë hapsanë
natë dhe ditë s'digjonej,
e bëri ixhat sahatnë,[1]
vaktinë të kupëtonej.

Zula mbeti perishan,
nuk i qasej dot shtëpisë,
Jusufi duron ndë zëndan,
i bën hamde Perëndisë.

---

1) Shpikësi i parë i orës ka qenë hazreti Ibrahim.

Ndë hapsanë vi i flit:
«Pse z'deshe' kundrë të thaçë...?»
Ga tallazi që e mbit,
më shumë e shton marazë.

«Z'deshe të rrinje rehat
ndë saraje, djalë beu,
zure më binje inat,
boja ime s'të pëlqeu...?!

Të divet na bëre rezilë,
se mua nukë më donje,
tani të riç me katilë,
gjete atë që kërkonje...!

U t'u luçë tuke qarë,
të më binje def meraknë,
tani të riç me kusarë,
të divet na prishe rehatnë...!

Trëmbeshe gaha gjunahu,
s'qaseshe për ç'kish dunjaja,
bëje dua tek Allahu:
«Të më ndaç ga Zulejhaja!»

Tani Allahu na ndau,
vështo ku të bëri vëndë,
po tani duro e mbau
ndë bodrume me çapkënë...!»

Jusufi i jep xhevap:
«Këtu tuk jam, s'më vjen rëndë,
se s'bëj gjunah, po sevap
të rri, sa kam për të ndënjë.

Zallëmetë më mundojnë,
se u mbajtinë vesh gravet,
atë punë s'e punojnë
kurrë djelt' e enbijavet...!

Ti s'kujtove aresatnë,
nd'atë fjalë të mos veje,
po ti digjove shejtanë,
ta hodh sevdanë tek meje.

Dëftomë se ç'kazandistë
që më vutë ndë hapsanë,
më ndë bisht vetë noistë,
posa më vutë iftiranë...»

Kaqë vjet po kuvëndojnë
edhe flisnë pas perdesë,
gjene ta shihnë e kërkojnë
ndë derë të hapsanesë.

Si sosi tamam muddetnë,
dimbëdhjetë vjet bitisi,
Zoti do t'i japë uxhretnë
me sevape që pohtisi.

Që s'e mbajti vesh shejtanë,
ndë vesvese s'i ujdisi,
kundër qeshi Zulejhanë,
Jusufi e sikterisi.

Edhe kur ju sos muddeti;
që kish ndënjë kaqë shumë,
një ditë thotë mbëreti:
«Kam parë ruja ndë gjumë».

Po që u gre gaha gjumi,
qëndroi ndë tahtapushë,
u tha: «Paçë mb'anë lumit
gjashtë qe të mëdhi shumë.

Paçë sikur u tha Nili,
shterpoi, s'mbeti as pikë,
nuk gjenë që të marrënë
as për të pirë ndë ibrikë.

Mbeti përrua i thatë
që do kish baltë e gurë,
duallë të tjerë shtatë,
të tjerë qe të sëmurë.

Vështuanë lartë, poshtë,
u kthenë më të gjithë anë,
vanë tek qet' e shëndoshë,
posi ulqitë i çanë.

Ata që ishnë të sëmurë,
u derdhë posi asllanë,
hëngërrë mish e lëkurë,
nishan më ta nukë lanë.

Se ata qe të sëmurë,
si ulq e kishnë surran,
dhëmëtë të trohisurë,
thonjëtë posi kapllanë.

Paçë dhe kallamë gruri,
karpoi nukë ish tharë,
siri shumë has më bërr,
si në kohë të beharit.

Paçë dhe shtatë të tjerë,
ishnë tharë dhe verdhurë,
allahten friti një erë,
i nakatosi me grurë.

U bënë të gjithë bashkë
edhe ndënja i vështova,
të njomatë më s'i paçë,
humnë, nuk i kupëtova».

Tabirxhivet u dëftoi,
gado ishnë anë mb'anë,
asnjë nuk e kupëtoi
që ta bën tabir rujanë.

«Kjo ruja ishtë ilham,
s'ja kuptojmë dot tevilë,
ishtë edgasi ehlam»
edhe griheshin e dilë.

Rrejani shumë pezmosi
ga tabiri që s'i dhanë,
që të gjithë i munxosi,
i dërgoi ndë hapsanë.

Dhe sakaja atë ditë
Jusufinë e kujtoi,
i erdhë ndë mënd porsitë,
shpejt Rrejanit i dëftoi:

«U kam ndë hapsanë një mik,
të tilë alim s'kam parë,
ruajnë e bën shumë tahkik,
s'ishtë me të dëftuarë».

Me një herë tha Rrejani:
«Hajde, të vijë t'i thoni,
të bëjë tabir rujanë!»
Për Jusufnë i dërgoi.

Nisi e dërgoj sakanë,
Jusufit i vate ndë derë,
ja bëri takrir rujanë,
ja bë tabir menjëherë.

Gjene u kthe me të shpejtë
edhe i vate Rrejanit,
ëndërra isht' e vërtetë,
më dëftoi Jusuf Qenani.

Zu e ja dëfton tabirë,
Rrejani shumë gëzonej,
«Vetë do t'e thosh më mirë,
t'ish mumqin që të lëshonej!»

Rrejani i tha sakasë:
«Këtë tabir po ta dijë,
e kam të parë të etbeasë,
po hajde thuaj, të vijë».

Jusufit vate i foli
gaha mbëreti me kartë
dhe Jusufi nukë dolli:
«Thuaj të pijesë gratë!

T'u thotë ç'kusur më gjenë,
jahot ç'kabahet më panë,
përse e bënë sebepnë,
që më hodhë ndë hapsanë...?

Sikundrë gjau vakija,
që më hodhë iftiranë,
sebep u bënë grarija,
që më futnë në hapsanë.

Ashtu kundr' erdhi mädeja,
që më hipi kabaheti,
më vjen turp gaha ulqeja,
nuk dal dot përpara mbëreti..,»

Vate e i tha mbëretit
si i tha ki ndë hapsanë,
foli gratë e i pjeti,
e bënë ikrar iftiranë:

«Ai s'bën punë të ligë,
po ne vetë u turpëruam,
na i tham' ai kish frikë,
me të rreme ja garkuam.

Ta dish, ishtë i pastruarë,
nevet zumë e kërkojmë,
na dogj sevdaja kufarë,
për punë të ligë e dojmë...!»

Rrejani shkroi fermanë,
me të shpejtë e dërgoi,
gjene e nisi sakanë:
«Hajde, të vijë t'i thoi!»

Ahjere Jusufi dolli,
vate i bë temenanë,
shtatëdhjetë gjuhë i foli,
ndë të gjitha i dha xhevapnë.

Shpejt skamninë ja duzdisi,
me bërshime anë mbanë,
Jusufnë e uturdisi:
«Rri, bëmë tabir rujanë!»

Edhe Jusufi qëndroi,
zu e i dëftoj rujanë,
ç'kish lathitë ja dëftoi,
Xhebrailë e pati pranë.

Tabirë arapçe ja ktheu,
Rrejani nuk e digjoi,
gjuhënë fort ja pëlqeu,
laqin nuk e kupëtoi.

I foli gjuhë ibrani,
gjene s'e mori vesh Rrejani,
i tha: «U këto s'i di,
s'i marr vesh se ç'gjuhë janë!»

«Kjo ishtë ibrani,
gjuh' e beni Israilit
dhe tjatra ishte arabi,
këtë e kish Ismaili».

U hoshandisnë, u pjenë,
sikundër ishtë iktizaja,
Jusufnë gjene e pjenë:
«ç'tabir bëre ga rujaja?

Një ga një të na biç tevil,
të gjitha kundër i pashë,
gjethe, uj' s'mbeti ndë Nil,
si ja dëftove sakasë!»

Nisi Jusufi i flet,
që i bën tabir rujanë,
i tha: «Do vinë shtatë vjet,
bereqetet hesap s'kanë.

Kaqë shumë do të jetë,
do marrëm sa për të grënë,
tjatëra do të mbetetë,
të kalbetë ndë lëmënjë.

Pastaje shtatë të tjerë
do vinë të shtrënguarë,
pikë shi do të mos bjerë,
koqe s'kanë për të marrë.

Kaqë do të shtrëngonetë,
s'mbetetë zok e hajvanë,
veçë ata që të kenë,
që t'u japënë të hanë.

Hiç hajvan do mos bërtasë,
s'digjonenë për të gjallë,
gaha shtrëngim' i havasë,
hajvan jashtë do mos dalë.

Të vëç njeri me fiqir,
të mbëledhë zahirenë,
mua mbi ta vërm' emir,
që të kollandris ulqenë.

Kur të vinjë proto seneja,
ga ata vjet të bollëkut,
të mbushetë hazineja
për vitëre të jokllëkut.

Kam nijet me tertip tim,
të kollandris hazinenë,
t'i lidh të gjithë ndë tajin,
të dajandismë ulqenë.

I tha dhe mbëreti vetë:
«Tjatërë përveçë teje,
më i mirë ku gjëndetë
t'i bëjë tertipe ulqesë?!

Për ti e paçë munasip
që të mbëledhç hasilatnë,
mbi të gjithë të jeç zabit,
gjithëvet t'u japç kumandë».

Se ai që e kish blerë
Jusufnë skllaf protoparë
dhe ai vdiq atëherë,
tjatër haznedar s'kish marrë.

Dhe Jusufi vu ustanë,
i dërtoi magazetë,
sikundër kish ihtizanë,
bëri dhe odë ndë dhetë.

Shumë të madhe e bëri,
që, sado të hidhë, s'gosej,
të mbëlidhej drithë, i tëri,
për shtatë vjet të mos bushej.

Edhe njerëzit i shkroi,
kundër tertipit që pati,
mbë të gjithë anë dërgoi
të mbëlidhej hasilati.

Ja mbëlodhë kollëxhitë
çdo që duhej për insanë
dhe për kashtë i kish porsitë,
të mbëlidhë për hajvanë.

Ndë sene të hasilatit
mblodhë gjithë bereqetnë,
kur erdhi vit' i qesatit,
e kish teqmil zahirenë.

Kur erdhi seneja tetë,
koqe bereqet nuk dolli
dhe pemë s'lëshoi fletë,
dhi a dele nukë polli.

Foli Xhebraili ndë hava,
një zë që s'ta prit fiqiri,
gjithvet u bë munada:
«Të usonetë Misiri...!»

Ndë mes të natës u grenë
gra, burra edhe sabitë,
kërkuan bukë e s'gjenë,
uja ndë bark u kish pikë.

Dhe kush pat ca kohë të haj,
sado të haj, nukë frrihej,
posi hajvanët ndë maj
gjumi natënë s'u flihej.

Dhe Jusufi protoparë
shpejt u dërgoi haberrë,
i foli pleq e muhtarë
e shkroi nufuz-defterrë.

Sa ishnë ndë një shtëpi,
të mirrë, u dha kararë,
të mirr një barrë për njeri,
sa të vjen tjatëra radhë.

Ua preu edhe pazarë,
barrënë e vu me narqe,
të vinë radhë për radhë,
të mirë me këto fijate.

Protoparë atë sene
u mbëlodhi gjithë paratë,
i vu gjithë ndë hazine,
që s'i mbeti para jashtë.

Vitn' e ditë ua shiti
me esvap, me xhevahirë,
tek ndonjë hanedan s'mbeti,
e mbëlodhi mir' e mirë.

Kur erdhi senej' e tretë;
ua shiti me hajvanë,
i katërti vit bakçetë,
arat e mulqet i dhanë.

Kur erdhi senej' e pestë,
ua mori gjithë ç'panë,
për bereqet dhanë skllevtë,
se tjatërë umidh s'panë.

Senen' e gjashtë e bitisnë,
me se ta blinë bereqenë,
apofastisnë e i shitnë
të gjithë, kush pati jenë.

Të shtatinë vit shahtisnë
e gjezdisnë nëpër gravë,
vetëhen apofastisnë,
gjithë u bënë skllev' e skllavë.

Ja vështo Zoti ç'punoi;
Jusufi qe skllaf i blerë,
po bëri sabër e duroi,
ja pagoi përnjëherë.

Hiqmetet e Perëndisë
nuk i dimë se çish janë,
çdo turk që të dajandisë,
nukë ja humbet sevapnë.

Pa sillois Zulejhanë,
ish zonjë, s'e di kimetnë,
nukë mërgoi shejtanë,
po bëri skllave vethenë.

Çilido njeri që s'dron,
ndë të ligë të mos jetë,
Allahu nuk ja harron,
për një ja paguan dhjetë.

Çilido të mos durojë,
që të jet ndë measijet,
vetëhenë do turpërojë,
për dunja, për ahiret.

Jusufi me një të parë
ndë pasqirë që u vështua,
tha: «Gjakundi s'ka të gjarë,
si ki nur që m'u dha mua».

Çunqë pëlqeu surratnë,
bë axheb me bukuri:
«Sikur të dalë ndë mezat,
do të zjasem me flori!»

Gaha pandehma që bëri,
njëzet grosh skllav u pagua,
u nda nga baba, ga gjiri,
dizet vjet tam u mundua.

Jakupi u bë zengjin,
mall e djelm shumë fitoi,
pas shtëpisë kish një jetim,
po kurrë as e kujtoi.

Jakupi s'e kupëtoi
që e kish marrë vesh sabija,
sabinë malli e pikoi,
zu e qan ga dhëmburija.

Hasha, ata që të kishnë
enbijatë vesvesera,
po këto sebep bëneshin,
që të kishnë derexhera.

Hasha, ndë pejgamberanë,
ndë gjunahe që të vinë,
ndë ëmrë të Allahut xhanë
nuk u dhëmbej që t'e jimnë.

Kur dolli ga hapsaneja,
e ve mbeti Zulejhaja,
nukë dil gaha haneja,
gjithënjë qan ga sevdaja,

Edhe vinë e kërkojnë
zabitë më të gjithë anë,
këjo nuk ua vi veshnë,
po duaj Jusuf Qenanë...

Takëmnë që pat e gjënë,
ua ndau hizmetçivet,
kur vinë, haberë i binë:
«Del të shoç nurin e sivet...!»

E ndau, fakire mbeti
dhe hizmeqarët i iknë,
u prish dhe gaha shëndeti,
mbet që sadeka i jipnë.

Kur lutej e bën duanë,
kërkonej derman nga iltë,
s'kish besuarë Allahnë,
gjersa erdhi ajo ditë.

Dhe ata nuk e digjojnë,
se ata mahlukë janë.
ç'thotë Allahu punojnë,
ata gjë ndë dorë s'kanë.

Kaqë kohë e kaqë zeman
vuxhuti ju përvëlua,
z'gjeti dot ilaç, derman,
atë ditë u kujtua.

«Këture që u bëj rixhanë,
që u flas e s'më digjojnë,
këta gjë ndë dorë s'kanë,
mënt e mija më mundojnë...!

Tani të besoj Allahnë,
që ka besuarë Jusufi,
që e nxorri nga zëndani,
e shpëtoi dhe nga pusi.»

Griti duart e surratnë
edhe ju lut Perëndisë:
«Dogri ta kam sjellë imanë,
që ti më ke jaradisë!

Edhe nga shirqi që paçë,
vetë e sheh që hoqa dorë,
se kudretnë tim e paçë,
që z'bëjë dot asnjë sorrë.

Ti vetë më jaradise,
ti ma dhe dhe hararetnë,
po për të madh tat bitise,
bëmë def këtë sëkëlldinë!».

Atë natë bë munaxhat,
gjëra ç'dha Zoti sabahnë,
me të vatë di-tre sahat,
ja bëri kabul duanë...

Jusufi jashtë kish dalë,
bënte devër kasabanë,
ajo haberrë e kish marrë,
kish dalë vështon sokaknë.

Zulejhaja psherëtiti,
bëri hamde Perëndinë
dhe të di duartë i griti:
«Ja Rab, nëmë hajërlinë...!»

Edhe Jusufi qëndroi
e pieti Zulejhanë:
«Dhe tani nukë të shkoi,
akoma e ke sevdanë?

Ti më gjan besove dinë,
ti keshe diell e hënë,
tani zë fill Perëndinë,
arrive ndë besë tënë.

E besove me të drejtë,
si ishtë për të besuarë,
me gjithë hak sifatetë,
s'ka të gjarë e të përgjarë».

«Dhe sevdaja jote mua
më ka tretur, më ka tharë,
për tjatërë gjë s'të dua,
po sa të të shoh dizdarë.

Eja kujto Perëndinë
dhe ato që të kam thënë,
ndëje më tëhu këmishnë,
ta zë, ta shtrëngoj me dhëmë!»

E zu me dhëmbë, ja hoqi
dhe bëri një psherëtimë,
dora ga mishi i dogji
posi koqe vetëtimë.

Zoti duanë ja dëgjoi,
axhëtisi Zulejhanë,
Xhebrailë shpejt ja dërgoi,
erdhi i solli fermanë.

Urdhëroj Allahu vetë:
«T'e marrç grua Zulejhanë»;
niqah vunë melajqetë,
ndë qiell bënë duanë.

Poqë digjoi fermanë,
i bë ita-at menjëherë,
dërgoi më Zulejhanë:
«Thoni, t'e ketë haberë.»

Elçitë vanë i thanë:
«T'u bë murati që keshe,»
sihariqinë ja dhanë;
«More burrë atë që deshe!»

Ga gazi zuri e qan,
i bën hamde Perëndisë:
«Ja Rab, të kam sjellë iman,
dhuromi ç'kam kazandisë...!

Nimetetë i ke të mëdha,
mbi qufër e shkova zoinë,
e shoh që kam bërë hata,
jam lerë ndë mushriqinë!»

Urdhëroj hazreti Xhelil,
qemalë edhe bukurinë,
njëzet vjeçe e bë tebdil,
e dëftoi madhërinë.

U nis, vate ndë konak,
sikundër kishnë adetnë,
vate, shtruan ndë jatak,
të dëftojnë insanietnë.

Jataknë poqë e hodhë,
Jusufit vanë i thanë,
të di bashkë u mbëlodhë,
Jusufi me Zulejhanë.

Zulejhaja ish ndë sexhde,
i bën hamde Perëndisë:
«Gjithë ç'kërkova, m'i dhe,
më nxorre ga ajo besë.»

Jusufi e fton ndë stromë:
«Ja ktheu të bëjmë adetnë,
pastaje, si të shpëtojmë,
e bëjmë dhe ibadetnë.

Hajde në jatak të flëmë,
si flënë insanë të tjerë,»
e hoqi gaha tumani,
ja çorri, si ja kish çjerrë.

Zulejhaja u kthe e qeshi
me hiqmetetë si vinë:
«Kur i thaç u, ki s'më deshi,
tani ma hodh' dashurinë.

E mba mënd herën e parë
që të zura ga këmisha,
keshe hakë për të marrë,
ma grise, kundër ta grisa.»

Pa vështo edhe merr ibret
me punë të Perëndisë,
më çdo punë ka një hiqmet,
ta bëjë si e ka nisë.

Zulejhaja kish sevdanë,
Allahut burrë ja lipi,
sevdaja i dogji xhanë,
pastaj Jusufit i hipi.

Mirë e shkuanë zoinë
Jusufi me Zulejhanë,
Zoti u dha dashurinë,
për shoqi-shoq hakikanë.

Edhe di djelm ju pohtisnë,
Efraimi edhe Meshanë,
qederetë ju bitisnë,
sa u poq dhe me të janë.

Gjene ndë fiqir ta kemi,
kundër keshëm hiqajenë,
gjene ku e lam' të vemi,
që kish mbushur hazinenë.

Ndë Misir s'mbeti pëllëmbë,
të gjitha u bënë emlaq,
njerëzit skllevë u bënë,
shpëtuan, s'u bënë helaq.

Ato sene të shtrëngimit
e goditnë dhe Qenanë,
gjithëvet u erdhi mjerimi,
Misir e Medjen e Shamë.

Të gjithë e digjuanë
zahirenë që kish vënë,
po vinë ga të gjithë anë,
mirrë bereqet për të grënë.

Jakupi dërgoi djelmtë,
për bereqet të garkojnë,
se mos ish Jusufi vetë,
atë punë s'e kujtojnë.

Gjithë tek Jusufi erdhë,
gjithë u kumbisnë me radhë,
me një tëllsëm hin e delë
dhe me armë garkuarë.

Jusufnë e kishnë vrarë,
s'ua kish pjellë fiqiri,
s'e bëjnë hesap se kish dalë,
ish bënë zabit Misiri.

Jusufnë s'e kishnë parë,
ta kuptojnë a ta njihnë
dhe mëndja s'ua kish marrë
se shpëtoi, që ta piqnë.

Dhe Jusufi atëherë,
poq i pa, i kupëtoi,
poqë i erdhë ndë derë,
ndë një odë i dërgoi.

Porsiti dhe hizmetçitë:
«Këta njerëz t'i vështoni,
se këta janë të mitë,
po ju të mos t'u dëftoni!»

Jatakë të mirë u shtroi,
u dëftoi salltanetnë,
hizmeqarëtë i dërgoi,
për gjithë Qenanë pjetnë.

Për të jëmënë e për t'anë
edhe për gjithë të tjerë
vaki-atetë u thanë,
e mori mirë haberë.

Jusufi zuri e qan
me lot e me sherëtimë:
«Ja Rab, të më bëç derman,
mos më ndaj me ta, po piqmë..!»

Dhe haberë s'e kish marrë
që i kish vdekur e jëma,
proto atëherë i thanë
e ju dogj zëmëra brënda.

Gjene i pjetnë tebdil:
«Çish e keni shoqi-shojnë?»
U flit një që e thoshnë Rubil,
të tjerëtë po digjojnë.

U thosh: «Jemi birazerë
të gjithë na që na shihni,
ishnë dhe nja di të tjerë,
mbet ndë shtëpi Beniamini.

Gjithë jemi martuarë,
kemi tri motra, babanë,
që po janë helmuarë,
sit' e tiret gjak u qajnë.»

Gjene prapë i bënë sual:
«Kaqë shumë përse qajnë,
mos u ka rarë ndonjë hall,
a mos kujtojnë azapnë...?

Ishtë griturë gazepi
ga të gjithë enbijatë,
për ata ç'ishtë sebepi,
që po qajnë ditë, natë?»

Djelmtë e dëftuan hallë:
«Kish një djalë të dashurë,
s'e dëftojmë dot xhemalë,
posi ill i këputurë[1]...!

[1]) Kështë quhet në Çamëri ai planet apo trup tjetër qiellor i cili, gjatë qarkullimit të tij, hyn në atmosferë dhe krijon kështu një vijë të ndritshme. Quhet edhe «Ill me bisht»: ç.

Na ndë fushë e keshëm marrë,
të shi aratë; bakçenë,
ulqit e muarrë xarrë,
copa-copa na e prenë...!

E kish bërë Allahu kadër,
që qajnë, nuk pushojnë,
dizet vjet kanë me qeder,
akoma nuk e harrojnë».

Sebepnë që u dëftojnë,
ndë se do që i piesnë,
duajnë që të garkojnë,
shpejt për ndë shtëpi të nisnë.

Duajnë t'jipnë haberë,
se kishnë ardhë protoparë,
se ja kishnë dhënë defterë,
t'u jip për njeri një barrë.

Kërkojnë për Beniaminë,
që e kish bajturë i jati,
këta s'duajnë t'u jipnë,
u thoshnë: «S'na del hesapi.

Ju doi që të na gënjeni,
të na mirri bereqetnë,
pa sillie, ku e keni,
pra të garkoni devenë,

Jahod, na silli shahit,
di që të jenë të drejtë,
po e pamë ne munasip,
të mirri për njëmëdhjetë.

Kjo do jetë zijade
duket që s'ishtë e saktë.
vështoni të qeshni me ne,
pse s'erdhi me juvet bashkë...?»

U thanë: «S'e lë babai,
s'e dërgon me ne ndë punë,
shëmbëllen si i vëllai,
se ka merak për Jusufnë.

Shahit s'kemi ku të gjëjmë,
se këtu nevet s'na dinë,
tjatërë care të bëjmë,
t'e sjellëmë kur të vimë.

Se ne t'ikimë pa tain,
na bën babai rezilë,
sa të vimë gjene, s'arrin,
ç'do të hajë me fëmilë?!

Po eja e bëni qerem,
nisnani, mos na mundoni,
inshalla dhe ai u vjen
dhe nevet do na besoni.»

«Çish thoi: «të bëni qerem»,
sa të garkoni, të dili,
po një të rrijë për rehem,
që, kur të vini, t'e silli.»

Si e panë që s'ua jipnë,
dhe ata hodhë kuranë,
ga të dhjetë, një të linë,
sa të sillë edhe vëllanë.

Kuranë në torvë e vunë,
sikundër që ishtë adeti,
ra që të linë Shemunë,
hulasaja këtu mbeti.

Jusufi u sillois,
i erdhi liksh për të vëllanë,
se e pa që u sëkëlldis,
porsiti të mos e mbanë,

Gjene u kthe e porsiti
atë që kish për të zigjasë
me kathetrope t'u viri
parat' e tiret ndë thasë.

«Shihni mos te kupëtojnë,
njeri vesh të mos e marrë,
t'i gjejnë vetë ndë barrë.»
ndë shtëpi kur të shkarkojnë,

Dhe vate vetë e u foli,
i porsiti pas perdesë:
«Babait tuaj t'i thoi,
duanë të mos e presë!»

Jusufi zuri e qan,
s'mun duron ga sëkëlldija,
se dhe për pejgamberanë
ishtë e rëndë ksenetija.

Të vëllezëritë vanë
ndë shtëpi bereqetnë e shpunë
edhe të gjitha ja thanë,
ç'u kish thënë për Jakupnë.

Gjithënjë zunë dëftojnë
timinë që u kish bënë,
«Beniaminë e kërkojnë
ta shohënë», kanë thënë.

Ata na dhanë haberë:
«Po s'erdhi dhe Beniamini,
s'u apëm tjatërë herë,
po këtu të mos na vini!

Çunqë e ka vënë usul,
ndë sanduke se ç'të jenë,
u jip ga një barrë grurë,
për gjashtë muaj ta kenë,

Nevet ndaje na mundoi,
i tham': «Nëmna për njëmëdhjetë,»
Beniaminë na kërkoi
edhe thosh: «Pse s'erdhi vetë?»

I thamë si ishtë vakija,
që nuk e lëshon i jati,
i shtonetë sëkëlldija
ga ai djali që pati.

Pastaje në be na lidhi,
tjatërë radhë ta silli
edhe na e prenë umidhë,
«Po s'erdhi, ju pre taini!»

Thesëtë vanë i hapënë
për t'adhjasurë bereqetnë,
paratë, sikundër i dhanë,
ndë qese lidhur i gjenë.

Gjene Jakupit i thanë:
«Ku e gjën të tilë sulltan,
shih, paratë na i dhanë,
na priti me të madh iqram!

Eja, mos na prish timinë,
po nëmna dhe Beniaminë,
se për këtë na porsinë,
inshalla sagllam do vimë!

Nevet të jemi qefilë,
që t'e sjellëmë sagllam,
marrëmë erzak për fëmilë,
njëmëdhjetë barrë tamam.»

«S'u besoj me të vërtetë;
se dhe përpara më qeshtë,
më thoshtë: «E ruajmë' vetë»,
më humtë Jusuf nishanë..!

Tani zutë më kërkoni,
më thoi për Beniaminë,
ca lezete më dëftoni
dhe këtit t'ja bëni trapnë..!»

Kaqë kohë i binë rixha:
«T'e lëç, të vemi të gjithë,
se bëmë jemin, pra na dha,
të mos bëhemi hainë!»

Gjenë kur sosnë bereqetnë,
zunë fëmila e bërtisnë,
ku të mirrë që t'u jipnë,
më ndë bisht apofasisnë.

Dhe Jakupi u bë razi
t'i nis të gjithë atëherë
edhe Beniaminë ta li,
të vi bashkë me të tjerë.

«Shihni, e mos bëni hile,
për atë Zot që besoni»!
Të gjithë i vuri ndë be:
«Beniaminë të vështoni!»

Gjithë natën i ormisi
t'i dërgon ndë udhë të gjatë,
nesëret me natë i nisi,
i përcolli me uratë.

U tha: «Hajedni ndë uratë,
Zotnë veqil e kam vënë,
shpejt, që të ma silli prapë
djalënë, si u kam thënë!

Gjithë porsitë q'u thaçë,
i fola gaha meraku,
pra na s'kemi gjë ndë dorë,
veçë t'u shpëtojë Haku!

Dhe ndë Misir kur të viji,
të mos hini ga një portë,
tek Zoti teslim të jini,
ga çdo e ligë u shpëtoftë!»

Në Misir u gren' e vanë,
për një portë nukë rinë,
ga di e ga di u ndanë,
sikundër kishnë porsinë.

Ndë Saraj kur van' e rinë,
dërgoi djelmtë tek porta,
di e di sikundër vinë,
i ndau ndë gjashtë oda.

Di e di bashkë u ndanë,
kundër ishnë me një nënë,
Benaminë atje e lanë,
ndë divan qaj, nd'atë lëmë.

Si i pa ata të gjithë,
që muarrë shoqi-shoqnë,
ndëpër oda van' e rinë,
për këtë nukë vështojnë.

Zuri qan me sherëtimë,
që shahtisnë hismetçitë,
i thoshnë: «Hajde të rrimë»
e ki hiç nuk i kthen sitë.

Të gjithë sa e pietnë,
s'ua dha dot hiç xhevapnë,
sa dolli Jusufi vetë,
u qafos me të vëllanë.

E pieti të vëllanë:
«Përse qan me gashërime,
që na përvëlove xhanë,
me gjithë atë sherëtimë...?»

Pra i tha dhe Beniamini:
«Me atë që erdha bashkë,
gjithë kush të tinë mori,
më lanë vetëmë jashtë.

Se ata të gjithë kanë
ga një vëlla me një nënë,
u e kam humbë vëllanë,
m'u lëndua plaga rëndë...

Tani, çunqë më piete,
të të thom si ishtë vakija,
se kam heqë shumë derte,
që më erdh paraponija.

Se keshë dhe u një vëlla,
të di jeshmë me një nënë,
të tilë nur ndë dunja,
Zoti njeriut s'ja kish dhënë!

I kish vatë dashurija
babait me atë djalë,
ja kish dhënë Perëndija
tamam mënden e xhemalë.

Ashtu goditi vakija
dhe këta vetëm e lanë,
dolli ulku ga foleja,
ua preu, dot s'e panë.

Babait që nd'atë ditë
që pësoi atë qeder,
i janë veshurë sitë,
mezi sheh të dalë ndë derë

Valideja atëherë
që pësoi atë musibet,
goditi që kish exhelë,
vdiqi, vate ndë ahiret...

Edhe tri motra që janë,
që i kam u me një nënë,
natë, ditë për atë qajnë,
më tjatërë punë s'bëjnë...

Dalën jashtë ndë një breg,
zënë të qarit e qajnë,
posi kukua kur thërret,
ndëpër male prill' e majnë.

U katandisnë si fili,
dike qarë natë, ditë,
thërresënë si birbili,
gjak u venë nga di sitë,

Dhe u sosnë tridhjetë vjet
që jemi bërë mubtela,
prim' atë të madh musibet,
s'ka bërë vaki ndë dunja.»

Si zu e ja angliadisí
Beniamini këto fjalë,
Jusufi e lejmonisi,
zuri e i qau hallë.

Dhe gaha dora e zuri,
të di bashkë brënda vanë,
ndë jatak të ti e vuri,
shpejt u suallë sofranë.

Poqë muarrë ga njëherë,
kundrë e kanë ulemaja,
Efraimi erdh ndë derë,
ndë grikë i mbeti llokmaja.

Gaha zëmëra gulçoi,
llokmanë prapa e ktheu,
poqë e pa, e pikoi,
mbë Jusufnë i shëmbëlleu.

Dhe Jusufi e pieti:
«Pse t'u zu buka ndë grikë,
thuajmë se çish të gjeti,
a mos të qëndrojë likshë...?

«Ki djali që erdhi brënda,
që riu tani ndë derë,
gjan me birazerë tënë,
që na humbi atëherë...!

Duar e këmbë ja vështova,
më gjau mb'atë vëllanë,
zeher' e atit kujtova,
e harrova dhe llokmanë.»

«Ndë vënd t'atit që të humbi,
ja, vëlla tuk më ke mua,
kushdo që bë, e zu zulmi,
inshallah ti t'u pagua...!

Ndë pjet për atë vëllanë
që s'e di se ç'e ka gjetë,
ta bëri Zoti muranë,
ja tuk jam u, dora vetë.

Atë që e pe ndë derë,
ai ishtë djali im,
që e njohe menjëherë,
emrin e ka Efraim!»

Gjene u zunë ndë qafë
Jusufi me Beniaminë,
suqut mbenë, e prenë llafnë,
u dukej si nd'ëndërrimë.

U vinë lotë ga gëzimi
dhe vështojnë shoqi-shoqnë
dhe s'munt u pritej rëkimi
ga musibeti që hoqnë.

Gjene Beniamini foli,
e pieti të vëllanë:
«Ndë Misir çili të solli,
të hëngri ulku, na thanë....?

«Mos piet se çish pësova,
ndë pus e ndëpër zëndanë,
me të mira ua pagova
gjithë atiret që më nganë...

Birazerët u mbëlodhë,
u riu ndë bark haseti,
ndë pus me ujë më hodhë,
tri dit' plasa ga sikleti.

Pastaj shkojtinë qiraxhitë,
erdhë ndë pus e më panë,
më nxuarrë për të shitë,
njëzet grosh para më dhanë.

Dhe si shkuan dica vjet,
gjene më hodhë buhtanë,
dica gra u bënë sebep,
shtatë vjet ndë haps më lanë.

Pastaj më erdhi qemali,
si më sheh ndë këtë radhë,
urdhëroi Dhulxhelali,
më kërreu faqebardhë.

Vetë e bënë ekrar buhtanë,
që më hipi kabaheti,
«Na e deshmë Jusufnë», thanë,
kur i pieti mbëreti.

Të tjerëvet birazerë
tani të mos u dëftojmë,
u i njoha q'atëherë,
për ti zura i shtrëngojë.

Tani një tertip t'u bëjmë,
t'u vë ndë thes një plashkë,
për kusëri t'ua zëmë,
të mos veç ti me ta bashkë.

Se u tani kam silloi,
se e panë që të dua
dhe këta janë hasetçi,
ta binë dhe ti si mua.»

Hizmetçitë brënda i thirri,
që i kish veqil ndë masë:
«Një gjë fshehura t'u viri,
ndë bereqet, brënda ndë thasë!»

Dhe ata nesëret vanë,
se ç'u punojnë, s'e dinë,
ua vunë mastrapanë
ndë barrë, që t'ua zinë.

Garkuanë mir' e mirë
dhe u nisnë për të dalë,
gjene ndë sokak u thirrë:
«Ktheni, se jeni kusarë...!»

«Ç'kini, pse na turpëroni
që na thërrisni kusarë?
Po u vodhmë, të na mundoni,
çilit t'ja gjëni ndë barrë!»

I vështuanë me radhë,
çunqë thanë: «Të na shihni»,
kur e gjenë mastrapanë
ndë barrë të Beniaminit.

E rrëmbienë me të shpejti:
«Hajde, do heqçë xhezanë,
për një vit skllav te mbëreti,
çunqë vodhe mastrapanë!»

Tek Jusufi gjene rinë,
zunë i binë rixhanë:
«Të na lëshoç Beniaminë,
mos ja sëkëlldis babanë...!

Ishtë plak i verbuarë,
pejgamber i Perëndisë,
kundër të tham' protoparë,
për një djalë isht sëkëlldisë.

Gjene bën merhamet, në daç,
për riza të Perëndisë,
cilëdo tjatër të mbaç,
se s'i vemi dot shtëpisë!

Me këtë djalë dajandis,
ga ai që u bë helaq,
i bëm jemin kur u nis,
që do t'e sjellëmë sak.

Eja, kujto Perëndinë,
mba di ga nevet të dhjetë,
të mos prishëmë jeminë,
ç'na bë, që xerkunë thjeftë!

Dhe i vëllai që pati,
kusërinë e punojnë,
na vjen liksh gaha i jati,
s'dimë çish t'i kuvëndojmë.»

Dhe ktheneshin e vështojnë
me gazep Beniaminë,
bijën kast që t'e mbulojnë,
të gjallë ndë dhe ta vinë.

Po s'i linë hizmetçitë
ndonjë punë t'i punojnë,
ahera kababet s'kishnë,
për zulm të parë i mundojnë.

Jusufi u bë xhevap:
«Me gazep pse e vështoni,
ju keni ardhë për fesat,
po s'mundi që t'e punoni.

Ju thoshtë radhën e parë
që «Jemi djelm Pejgamberi»,
tani u zunë kusarë,
me ç'surrat ndë alem do deli...?

U kam dhe tjatërë kadi,
t'ua bi huqmë davanë,
na thoni: «E vodhi ki»:
ju vratë dhe të vëllanë...!»

Si pati Nuhu gjeminë
edhe Ademi kurbanë.
që e bëjnë fark të liknë,
Jusufi pat mastrapanë.

Për donjë dava kur vinë,
vinë zinë mastrapanë,
(mungojnë dy vargje)

Ta zi haksizi me dorë,
nuk i digjohej sadaja,
kuj t'i trokëllit me forë,
ati i bënej davaja:

Bëri ëmërë Qejalë:
«Pa trokëlli mastrapanë,
çish thotë për këto fjalë,
të rreme a të drejta janë?»

E qëlloi e s'u digjua,
ga haseti madh që panë,
ndë alem gjithë u kupëtua
q'e kishnë humbë vëllanë.

Beniamini bën sehir,
se sëkëlldinë e kish nxerrë,
silloisej me fiqir,
çish s'e njihnë birazerrë!

Edhe umidhë ua preu,
që s'e lëshon Beniaminë,
të gjithë jashtë i kërreu:
«Hajde, vështoni shtëpinë!»

Duall' e rrinë ndë sokak
dhe t'ikinë, ku të vinë.
ku të vinë, s'kishnë jatak,
ç't'u thoshnë për Beniaminë!

Më i madhi tha një fjalë:
«Çish t'e prishëmë jeminë?
Dhe u nuk iki i gjallë,
të lë këtu Beniaminë...!

Të ndahem gaha vëllai,
këtu vetëmë të jesë,
çish xhevap t'i jap babait
për këtë, kur të piesë?

Nukë sosi ç'punuamë,
dizet vjet natë e ditë
qan për Jusufnë që muarrmë,
sa ju zbardhë të di sitë.

Po hajde, mirri devetë,
bereqetnë ndë shtëpi shpiri
dhe për nevet ndë pietë,
thoi ç't'u presë fiqiri!

Se na vetë ashtu punuamë
dhe atë ditë u thashë,
Jusufnë ndë qafë e muarrmë,
nukë desha ta humbasë.

Tani më hiç mos i flini,
çunqë kështu ish jazija...!
Ju mirri devet' e hiqni
mos na presënë shtëpija!»

Muarrë barrët e iknë,
më të madhë atje e lanë,
të vështon për Beniaminë
çish do t'i binë xhezanë.

Dhe Jakupi, poqë vanë,
me të shpejtë i pieti:
«Di të tjerëtë ku janë,
vdiqnë ndë udhë a ç'i gjeti?»

I thanë që «nukë vdiqnë,
që të di të gjallë janë,
na bajtënë Beniaminë,
se u vodhi mastrapanë!

Se ne për kusar s'e dimë,
t'e dijëm, s'e keshmë lënë,
na vetëmë do të hijëm,
po dhe ti s'na keshe thënë.

Ashtu rrodhi taksirati,
masënë ndë thes e vuri,
për një vit skllav na e mbajti,
se ndë thes t'atit e zuri.

Ta dijëm se e pësojmë
si atë herën e parë,
Beniaminë s'e kërkojmë
dhe të mbetej dhe një barrë.

Po ai vetë e kërkoi
që do të vidh mastrapanë
dhe nevet na turpëroi,
vetë do heqë xhezanë.»

«Këjo nuk ishtë si thoi
dhe ai nukë ka vjedhë,
po nefsi juaj u mësoi,
ndë bela vështon t'u hedhë.»

Shumë hall të madh pësoi
që i humnë të tre djeltë,
dizet vjet tamam duroi
dhe ki ua di hiletë.

Me të shpejtë shkroi një kartë:
«Hajde, ndë Misir ta shpiri,
inshallah do t'ua japë,
djalënë tëhu ta biri!»

Vanë kartënë ja dhanë
poqë vështoi jazinë,
lotë ndë dushek i ranë
të divet me Beniaminë.

Ja kish shkruarë ndë kartë
Jakup Israil-ullahu:
«Na ndë soj s'e kemi patë
të qepemi ga gjunahu.

Ibrahimi, gjishi inë,
të madhe bela që hoqi,
ndë zjarr të madh e vërvinë,
po desh Allahu s'e dogji.

Amixha inë; Ismaili,
për Zotn' e ti e dha xhanë,
po urdhëroi Xhelili,
e bëri vaxhip kurbanë.

Po, në daç, bënu mukajet,
për riza të Perëndisë,
se dhe u kam të madh hasret
për djalë që më ka lipsë.

Ti këtë po e lëshove,
ta paguan Perëndija,
se ti hallet m'i mësove,
si më ka gjarë vakija.»

Jusufi xhevap i dha:
«Kartënë që më dërgove,
sot e bëra mutalea,
mora vesh gjithë ç'më shkrove.

Më shkruaje për babanë
edhe për të gjithë sua,
cilido që hoq belanë,
që ndë dunja ju pagua.

Po bën sabër, të keç sevap,
të bënenë derexhera
dhe soi juaj nuk pat
qedere dhe vesvesera.

Tani mos bën shiqajet,
të të pjekë Perëndija
me gjithë ata që ke hasret,
të të ikë sëkëlldija.»

I vate gjene Jakupit,
poq e hapi, e mësoi
që e kish shkruar Jusufi,
atëhere e kuptoi:

«Kam umidh në Perëndinë,
do t'i gjeni të tre bashkë,
Jusufnë dhe Beniaminë
dhe atë që i pret jashtë.»

I thonë: «Ti kapërceve,
punë tjatërë na thua,
Jusufnë të gjallë e ktheve,
ai tani u harrua...»

«Këto kuvëndet e mija
që u thom, ju s'i digjoni,
po i di vetë Perëndija,
ca që ju s'i kupëtoni.

Hajde, mos prisni umidhë
gaha Zoti më xhdo punë, ,
se të di bashkë do vinë,
Beniamini me Jusufnë!»

Gjene këta prapë u nisnë,
kartënë vanë ja shpunë,
atë llaf e dushendisnë,
që e thanë me Jakupnë.

Kartënë vanë ja dhanë,
që t'u lëshon Beniaminë
edhe ja bënë rixhanë,
të gjithë ndë këmbë i binë.

U thotë: «Vallë, e dini
Jusufit se çish ja bëtë?
Gjene atë tahmin kini,
se dhe ki u nxorri mëntë...!»

«Vallahi e kuptuamë,
që ti je Jusufi vetë,
ne tani u turpëruamë,
se na duallë hiletë.

Urdhëroi Perëndija
ti nimetetë t'i shtoi,
nevet na zu ligësija,
gjunahu na turpëroi.

Po eja e bën merhamet,
nevet mos na bën xhezanë,
çunqë të dha Zoti nimet,
sebep, gjunahetë tanë!»

U tha që «haxhet mos kini,
hakën ua kam dhuruarë,
dolla dhe u të më shihni,
gjera më sot s'më keshtë parë».

Kaq dit' u bëri davet,
i prit me shumë të mira,
drekë, darkë u bën zijafet,
të mos kishnë sëkëlldira.

U tha: «Mos u silloisni,
një punë që u punua,
atë mos e dushendisni,
gaha meje u dhurua!

Mirë e dini Perëndinë
dhe me sifate të lartë,
e ka të bolltë dhurimnë,
i dhuron gjithë hatatë.

Bëni tobe me të drejtë,
ga Zoti dhurim kërkoni,
gaha gjithë gjunahetë
birdaha mos i punoni!»

U dha edhe një këmishë,
i dërgoi tek i jati:
«Me këtë të fshijë sitë,
t'i bitisetë muratî.»

Me të dalurë elçiu
me sihariq mbi Jakumnë,
një merudhi na i riu,
vate i riu ndë hundë.

Tek ish ndë mes të mexhl[illegible]t,
ndë hundë ja shpuri [illegible]a,
ki po vështon e shahtisi,
prit që t'i vinë te dera,

Të gjithëvet u dëftoi:
«Ja, më erdhi merudhia».
I thanë: «Ti të marroi,
ca helmi, ca pleqëria.

Dizet vjet i bërë botë,
ti po qan për atë djalë,
ajo mënde çish të thotë,
e pret të të vijë i gjallë...?!»

«Ga Zoti umidhë s'e pres,
inshalla që do më vinë,
të di bashkë, sikundër i pres,
Jusufnë dhe Beniaminë...

Arriti edhe elçiu,
erdhi i dha sihariqnë:
«Na dhe këmishën e fshihu,
sitë gjene të të vinë!

Dhe Jakupi atë ditë
pa nihajet u gëzua,
me këmishë fshiu sitë,
atë kohë u shërua,

U mbëlodhë sa që qenë,
gjithë tek Jusufi vanë,
u pati Zoti kismetnë,
ua bitisi muratnë.

Jusufit i dhanë haherë,
që i vinë akrabaja,
shpejt e mbëlodhi asqerë,
dolli gjithë kasabaja.

Këta, kundër ishnë nisë,
përjashta Misirë u poqnë.
i bëjnë sexhde Perëndisë,
që e panë shoqi-shoqnë.

Ua bitisi muratnë
ndë këmë i puthnë dhenë,
Jusufnë poqë e panë,
Zotit ja bënë sexhdenë.[1]

1) Në doreshkrimin e Shaban Xhafer Goxhait nga Konispoli dhe në tri doreshkrime: dy të Nasir Sulajmit nga Delvina e një të Ali Abdulhalimit — po nga Delvina — gjenden edhe 56 vargje të tjerë. Po, nga krahasimi që u bëri Osman Muderrizi — i cili edhe e transliteroi doreshkrimin e poemës «Jusufi e Zulejhaja», doli që ato vargje ishin të shtuara nga kopjuesit e lartpërmendur apo nga parakopjues të tjerë. Në to përsëriteshin gjëra të thëna, po në mënyrë shumë të varfër, pa ndonjë vlerë artistike.

FJALORTH

A

Adhap, azap (ar.) - Vuajtje, dhimbje, mundim, keqheqje. Ndëshkim. Hidhërim.

Adhjas (gr.) - Liroj, zbraz (një thes, një dhomë etj.).

Agllandis (gr.) - Dorëzoj, çoj ku duhet, përcaktoj, vë në vend.

Ahd (ar.) - Fjalëdhënie. Fal, tregoj udhën e drejtë.

Akçi (ar.) Gjellëbërës.

Alem (ar.) - Popull, botë, publik, gjithësi, rruzullim.

Alim (ar.) - Dijetar, i arrirë.

Allahten (ar.) - Papritmas, befas.

Anamesa (gr.) - Ndërmjet.

Apofastis (gr.) - Marr parasysh, vendos,

Aresat (ar.) - Gjyqi i përtejjetshëm, gjyqi i pasvdekjes.

Asllan (ar.) - Luan.

Asi (ar.) - I pabindur, i pamëshirshëm, keqbërës, I egër, i panështrueshëm.

Ashk (ar.) - Dashuri, dashuri e zjarrtë.

Aziz (ar.) - I nderuar, i shtrenjtë.

B

Baldi - Të hollë, shuarje zemre. Vilani.

Barkaç (tq.) - Një farë kove prej bakri, po me formë të kundërt nga ai i kovës e ndonjëherë edhe cilindrik. Bakëraç (tq.)

Bash (tq.) - Krye.

Bashlladis (tq.) - Filloj, ndërmarr (një punë, një veprim), nis.

Bejan (tq.) - Bërje e ditur, shfaqje, shpallje, njoftim, vënie në dukje, zbuluarje (e një trimërie, një të fshehtë), treguarje.

Bërshim - Një lloj peri shumë i fortë e shumë i durueshëm ndaj lagështisë. Zakonisht përdorej për qepje plagësh dhe sende ku qepja duhej të qëndronte për një kohë të gjatë.

Birdaha (at.) - Edhe një herë, herë tjetër.

Bitis (tq.) - Mbaroj, përmbush, plotësoj, kryej.

Buhtan (ar.) - Shpifje, padijë a kallëzim i gënjeshtër.

C

Cingris - Ngacmoj, nxis.

Ç

Çallështis (tq.) - Punoj, mundohem për të bërë një punë.

Çare (pers.) - Udhëgjetje, rrugëzgjidhje; bar, shërim.

Çerpi - Shkak, mënyrë.

Çunqë (pers. - çynky) - Meqë, pasi, sepse.

D

Dabelul - Erdhi, do të vijë.

Dajandis - Qëndron, i bën ballë. I dal krah, ndihmoj

Davet (ar.) - Ftesë, grishje, thirrje, mbledhje.

Def (ar.) - Shporr, zhduk, mërgoj.

Dej - Pasnesër.

Derexhe (ar.) - Shkallë, lartësim (zbritje), pasojë.

Devër (ar. - devir, devre) - Kohë, ripërtëritje, rrotullim, sjellje, shetit, kqyr. vërej; vërtitje, rrethsjellje, qarkullim.

Dizar (ar.) - Fytyrë.

Dogëndis - Prek, rëndoj, fyej.

Dogri (tq.) - Drejt, drejtpërdrejt. I përpiktë, zemërçelët, i sjellshëm.

Dushendis - Mendoj, përmend, zë në gojë, parashtroj.

Duzdis (tq.) - Rras, mëshoj, tendos, pajis, Mbuloj, Vesh.

DH

Dhëmburi. dhëmbëli. dhëmshuri - Dhëmbje, keqardhje. Mëshirë.

E

Ebed, ebedijet, ededi (ar.) - Përjetësim, pafundësi (kohe). I përjetshëm, i pavdekshëm.

Edgasi - e shenjtë, paralajmërim hyjnor; e zbritur (nga lart).

Ehalija (ar.) - Gjindja, njerëzia, njerëzit.

Ehlam (ar.) - Ëndërr.

Elçi (tq.) - Përfaqësues, lajmëtar, i dërguar.

Emir (ar.) - Komandues, kryetar.

Emlaq (ar.) - Mirësi, zotërim, patundësi; i patundshëm (mall).

Enbija (ar.) - Profet.

Epizoi (gr.) - Për jetë, me jetë (dënim).

Erzak (ar.) - Ushqim, zahire, rezervë, qeverisje, përkujdesje.

Esvap - ethvap) (ar.) - Plaçkë, teshë, rrobë. Sende të çmueshme.

Etbea (ar.) - Shpurë, suitë.

Exhel (ar.) - Mbarim, cak, kohëvdekje. Vdekje.

Ezijet (ar.) - Cfilitje, vuajtje, mundim, Veprim i dhunshëm.

F

Fai (gr.) - Gjellë.

Fakir (ar.) - I mjerë, i varfër, i shkretë, I pakët.

Farfuri - Rroke porcelani i cilësisë së lartë.

Feks - Ndriçon, zbardh (agimi). Ndrit, shkëlqen.

Ferman (pers.) - Dekret, vendim. Urdhër i lartë.

Fesat (ar.) - Zënkë, gurgule, shamatë, çorroditje, Kryengritje.

Fijat (ar.) - Çmim. vleftë.

Foti (gr.) - Bishtuk.

G

Gaflet (ar.) - Habi, pakujdesi. Pamënçuri. paurti, pavëmendshmëri. Ngadhnjyes, mundës;

Galip (ar.) - Fitimtar, mundës, ngadhnjyes, epror, i lartë, i epërm.

Gibet (ar.) - Përgojim, përhelqje, marrje nëpër gojë; përçmim.

Gravë - Guvë shkëmbore, brimë malore. Shpellë (gr.).

Gremis (gr.) - Rrëzoj, përplas, përmbys.

Gushepset - Përfytet.

GJ

Gjemi (tq.) - Anije.

H

Had (ar.) - Cak, prag, shqem, kufi, nisje, i mprehtë.

Hajran (ar.) - Mahnitës, mrekullues, soditës. Këtu, Çorroditje, i çorroditur,

Haksiz (tq.) - Drejtësimohues, vërtetësishkelës. Zotmohues.

Hak-u (ar.) - I drejti, drejtuesi. Drejtësi.

Hamd-e (ar.) - Këndim lutjeje («Elhamdu lil-lahi...»)

Hane (pers.) - Banesë, shtëpi. Hanedan - I parë, derëçelur.

Haps (ar. - hapis) - Burg, burgim.

Hararet (ar.) - Nxehtësi, zjarr, rrëmbim, gjallëri, ashf, ngacmim, ethe.

Harcë (tq.) - Shkëmb; gurë të mëdhenj të pashkulshëm.

Haset (ar.) - Cmirë, lakmi, zili.

Hasilat (ar.) - Prodhim, vjelje (bereqetesh etj.); të ardhura.

Hasret (ar.) - Hidhërim, keqardhje, ankim, pendim; dëshirë, mall.

Hasha (ar.) - Mohim; e pamundur.

Hasherat (ar.) - Kandër, krimb, insekt.

Haxhet (ar.) - Domosdoshmëri, nevojë, vështirësi, shtrëngim, kërkesë.

Haznedar (ar.) - Të ardhurambledhës, thesarruajtës (thesarkujdesues).

Hazret (ar.) - Dritërues, madhëri, shënjtor.

Hiqaje (ar.) - Tregim, kallzim, përrallë. Histori, njotim, lajm.

Hiqmet (ar.) - Dituri, urtësi, mënçuri, pjekuri, nder, ndodhi, ember.

Hosh (pers.) - I këndshëm, i pëlqyeshëm, kënaqës, gazbërës, i dashur.

Hoshandis - Përshëndes, përfalem; përkëdhel.

Huzur (ar.) - Qetsi; shtesë.

I

Ibadet (ar.) - Lutje besimtari në ceremonitë e caktuara fetare.

Ifade (ar.) - Dëshmi, Kallëzim, tregim, shfaqje, shprehje; shkoqis. Them.

Ibrani (ar.) - Çifutçe, jahudiçe.

Ibret (ar.) - Mësim, shembull.

Iftira (ar.) - Shpifje; faj.

Iqram (ar.) - Nder, nderim.

Ikrar (ar.) - Miratim, pëlqim. Vendim.

Iktiza (ar.) - Domosdo, nevojë, duhuri (duhshmëri). Rregulli.

Ilet (ar.) - Mangësi, e metë, gjymtim. Sëmundje toke.

Ilham (ar.) - Frymëzim nga Zoti. Tregim (zbulim) nga Zoti. Vënie në dukje nga Zoti. Frymëzim hyjnor.

Iqindi (tq.) - Midisi i pasmesditës. Kohë faljeje e besimit islam në gjysmë pasmesditën.

Ispat (ar.) - Dëshmi, provë, vërtetim.

Istintak (ar.) - Hetim, pyetje, marrje në pyetje.

Ita (ar. - itaat) - Bindje, nënshtrim, ndëgjim, nder.

Ixhabet (ar.) - Domosdoshmëri, kërkesë e patjetërshme, duhuri. Pranim.

Ixhat (ar.) - Shpikje, shteggjetje. Shkas.

Izin (ar.) - Lejë, pushim.

J

Jaci (ar.) - Kohë për faljen e dytë të pasmbrëmjes.

Jahot (ar.) - Apo.

Jakut (ar.) Rubin i kuq

Jaradis (tq.) - Krjoj, ngjall, ngjiz.

Jatak (tq.) - Dyshek, strehë, vendstrehim.

Jatosi - Goditi. qëlloi, takoi.

Jatrua (gr.) - Mjek, shëronjës.

Jenë - Fëmijë.

Jemin (tq.) - Betim.

Jerleshtis (tq.) - Vendos, hedh, gjej. I gjej vendin e përshtatshëm. Vendos ku duhet. Siguroj.

Jokllëk (tq.) - Moskamje, s'kamje, mungesë.

K

Kabahet (ar.) - Faj, gabim, shkelje.

Kabull (ar.) - Pëlqim, pranim. Marrje.

Kadër (ar.) - E thëna, e shkruara, e paracaktuara. Fati.

Kajde (ar.) - Drejtshtrim, mirërenditje. rregull, përqyeshëm.

Kapllan (ar.) - Tigër.

Karpua - Kalli, kokërr. Bërthama e kokrrës (grurit. misrit etj.).

Kast - Cmirë, lakmi, zili.

Kathetropo - Çdo humbje, çdo grackë. Duhet të jetë: «Kallotropo»: Grackë, kurth; zhdukje dinakërisht, Zhdukje mjeshtërisht.

Kazandis (tq.) - Fitim përfitim, dobi. Epërsi, fitim mërgimtari.

Kollandris - Administoj, përdor, rregulloj.

Kolla (kolli) - Ngrehja (ngrirja); shkëlqimi, pamja.

Kollëxhi - Mbledhës të ardhurash shtetërore; shoqërues t'ardhurambledhësish qeveritarë.

Ksenati (gr.) - Huajëri, mërgim; të huaj; ndërmjet të huajsh.

Ksiqis - Shkoqis, shpjegoj.

Kudret (ar.) - Fuqi, mund, pushtet, sundim. Mundësi

Kufar - Shtat, trup.

Kuko - Qyqe.

Kull - Rob, skllav, shërbëtor.

Kura - Short, kohëthirrje ushtarake e shërbimit të detyruar.

Kurm - Shtat, trup.

Kuruntinë - Kthinë e posaçme takimesh në burg.

Kuturis - Marr parasysh; e mbledh, vendos.

Laqin (ar.) - Po, por.

Lathit - Gaboj.

Lejmonis (gr.) - Mëshiroj, ngushëlloj, çmërzis; i qaj hallin.

Libë - Pjatë.

LL

Llatho - Gabim.

Llokma - Kafshitë.

M

Mabejxhi (ar.) - Zyrtar i lartë që hyn e del lirisht në zyrën e mbretit për punët zyrtare. Ndërlidhës ndërzyrtar. Shambellan.

Mahut (ar.) - Hyjnizim, idhull, perëndishmëri, trupore hyjnipërfaqësues.

Mahluk-at (ar.) - Qënie e pavetëdijshme, krijesë jo njerëzore.

Mahsher (ar.) - Përmbytje, prishje. Zënie ngushtë; u zu ngushtë.

Martiri (ar.) - Dëshmi. padijë, kallëzim.

Masllahat (ar.) - Punë, çështje, mjeshtëri, shpikje; punë me rëndësi. Interes.

Masijet (ar.) - Mëkatë, mosbindje (mosnënshtrim) ndaj Zotit. Dalje para gjyqit të përtejjetshëm.

Mastrapa - enë bakri e ngjashme me broken prej qelqi.

Mbodhis - Vonoj.

Medet (ar.) - Ndihmë. Dhënës.

Meleq (ar.) - Ëngjëll.

Merhamet (ar.) - Mëshirë, keqardhje, dhimsuri. Hir, hijeshi. Përdëllim.

Meshhur (ar.) - Në zë, i mirënjohur, i shquar, i famshëm.

Mezat (ar.) - Ankand, vendshitje.

Mëlshi - Mushkëri.

Middet (ar.) - Kohë (e caktuar), pjesëz kohe; një hop. Mudet.

Minj - Cati, për pak.

Mubtela (ar.) - I goditur, i përkryer.

Muhtar (ar.) - Kryeplak. Kryetar këshilli fshati a bashkie.

Mulk - Zotërim, pasuri, mbarësi, mirëqënie, mirësi; lulëzim, begati.

Munada (ar.) - Thirrje, të thirrur.

Munasip (ar.) - Mundësi, me vend, e përshtashme, e udhës.

Mumqin (ar.) - Mundësi, e mundshme.

Munxët - Paçet. Munxos - Mallkoj.

Murat (ar.) - Qëllim, synim, dëshirë, përgjërim, mirësi; zotim.

Musibet (ar.) - Kob, tmerr; mjerim, gjëmë, mynxyrë. Vuajtje.

Mushavere (ar.) - Këshillim, kuvend.

Mutalea (ar.) - Studim, lekim, mendim, ruajtje, arti i të lexuarit.

Mutllak (ar.) - I plotë, i tërë, i pakufishëm, i pakushtëzuar, i prerë.

Muxhize (ar.) - Habi, çudi; mrekulli (e një profeti).

N

Naguli (gr.) - Përzierje, të ndohtë, vjellje.

Nakatos (gr.) - Përziej, trazoj (diçka).

Nark - Çmim i caktuar (për një send).

Nasqiris (gr.) - Tfilloj; bëj punët e shtëpisë (brenda).

Nefs (ar.) - Lakmi, kryelartësi.

Nihajet (ar.) - Tejet, masë, fund, mbarim.

Nimet (ar.) - Mirësi, begati, këndshmëri, shije.

Nigjah (ar.) - Marrëveshje martese. Veprim, punë.

P

Perishan (pers.) - I vrarë shpirtërisht, i dëshpëruar, i dërrmuar.

Pezmos (gr.) - Zemërohem; shfaq pakënaqësi.

Përhelq - Përgojoj, marr nëpër gojë; përflas.

Pikua - Helmua, hidhërua; i theri.

Pohtis (gr.) - Shpik, zbuloj, ngreh; krijoj, ndërthur.

Pramatar (gr.) - Vogëlinashitës shëtitës.

Proto (gr.) - Para, përpara, fillim.

Q

Qemal (ar.) - Përkryerje; përsosmëri; pjekuri, ngjitje, lartësi.

Qefil (ar.) - Dorëzënës.

Qelës (diku-diku: qulsi) - send i shtrydhur (limon)

Qerem (ar.) - Bujari, nder, mirësi; mëshimadh; mirëbërës, i nderuar.

Qesat (ar.) - Shterpësi, moskamje e thellë; zi:

Qesëndi - tallje, përqeshje

Qole (ar.) - Rob, skllav.

Qufër (ar.) - Mosbesim, femohim, Zotpërçmues.

Qoteps (gr.) - Frikësoj.

R

Rehem (ar.) - Peng.

Riza (ar.) - Pëlqim, dashje, kënaqësi, vullnet.

Rodhi-ra - Trëndafil-a.

Ruja (ar.) - Ëndërr; njoftim i Zotit; paralajmërim (i Zotit).

S

Sabër (ar.) - Durim; qëndresë.

Sabi (ar.) - Fëmijë, vocërrak, i mitur.

Sada (ar.) - Tingull, zë.

Sagllam - Përpikëri, saktë.

Saka (ar.) - Ujëdhënës; pijedhënës; pijepërgatitës.

Seher (ar.) - Zbardhëllim, të gdhirë, agim. Majë.

Sene (ar.) - Vit.

Sexhde (ar.) - Rënie përmbys; rënie me fytyrë për tokë në shenjë nderimi.

Sifat (ar.) - Cilësi, veti.

Skamni - Karrigë.

Stromë - Dyshek.

Suhubet (ar.) - Bëj shoqëri, shoqërim.

SH

Shahtis - Habitem, shushatem, hutohem, mbetem pa mend.

Shehvet (ar.) - Epsh.

Shirqëria - Idolatria. (Shirk - Idolatër).

Shkarfos - Zbërthej, shkatërroj.

T

Tabir (ar.) - Kuptim, shkoqitje, domethënie, zgjidhje.

Tabirxhi - Ëndërrzbërthyes, ëndërrshkoqitës, ëndërrdomethënës.

Tahkik (ar.) - Hetim, pyetje: Shqyrtim.

Tahmin (ar:) - Hamendje: Këtu, parashikim.

Tahtapushë - Fron (mbretëror); e ndara e Fronit.

Tahtapapushë (ar.) - Heqka, lëpitka.

Tahut (ar.) - Barrë, përsipër, zotim, peng, detyrë.

Tajin (ar.) - Pjesë (ushqimi); racjon.

Takdir (ar.) - Vlerësim; urdhër i Zotit. E thëna, paracaktim i Zotit.

Takrir (ar.) - Kallëzim, rrëfim, shprehje, lëvizje.

Tembih (ar.) - Paralajmërim; parathënie. Porosi, këshillë. Rekomandim.

Teqmil (ar) - Gati, krejt, i tërë, i plotë, mbarim, plotësim.

Tesuf (ar.) - Hidhërim.

Tevdil (ar.) - Ndryshim (pamjeje), zëvendësim; hapur, prishje, keqësim.

Tevil (ar.) - Shkoqis, zbërthej, tregoj. Shtjellim larg tekstit.

Timi (gr.) - Vlerë, nder

Tixhar (ar.) - Tregëtar.

Tobe (ar): - Shfajësim, rrëfim, pendesë:

Trohis - Mpreh.

TH

Thjamaks (gr.) - Mahnit, shtang, tmerroj, kall datën.

Thjamë (gr:) - Habi, mrekulli, gjëmë:

U

Ulqe (ar:) - Popull, vend, vis; atdhe, bashkëvendës.

Umidh (pers.) - Shpresë.

Uturdis (ar.) - Rri, ulem:

V

Vahj - Zbulim nga ana e Zotit të një profeti. Lajmëtar hyjnor:

Vakiate - Ndodhi, ngjarje.

Valide (ar.) - Nanë, mëmë, nënë.

Vardha - Vazhdimisht, pa pushim, pa ndërprerje. Çurk. Rrëke.

Vaxhip (ar.). - Detyrimisht, detyrues, i domosdoshëm, Nevojitës.

Velinimet - Mirëbërës.

Veqil (ar.) - Përfaqësues, nëkëmbës.

Vjas (gr.) - Ngut, nxitim. Shpejtësi.

Vukuf (ar.) - Bindje, njoftim, marrje vesh.

Vuxhut (ar.) - Trup, shtat, qënie, jetesë.

XH

Xhebrail (ar.) - Meleq, ëngjëll frymëmarës:

Xhedë (ar:) - Maturi, rëndësi, me tërë mend. I matur, i zellshëm; i rëndësishëm.

Xhelil (ar.) - Zot; i madh, i madhnueshëm. Mirëbërësi, më i larti, i kulluari.

Xhemal (ar.) - Bukuri, i bukur, hijeshi, pamje, tërheqës. Fytyrëpashëm.

Xhemat (ar.) - Tubim, mbledhje, grumbullim.

Xheza (ar.) - Dënim, ndëshkim.

Xhuhela - Njeri krejt i pa ditur (pa dituri)

Xhumbush (tq.) - Argëtim, dëfrim.

Z

Zabit (ar.) - Sundimtar, qeveritar, urdhërues, oficer.

Zallëm (ar:) - I egër, i vrazhdë, i ashpër, shtypës.

Zem (ar.) - Për faqe të zezë, poshtërim, marrje fytyre.

Zëndan (tq:) - Mundim, vuajtje, burgim,

Zijade (ar.) - Gënjeshtër, përrallisje, kodra pas mali; fjalë në erë.

Zigjas - Peshoj:

Zijafet (ar:) - Gosti, pritje. Banket, festim.

Zoi (gr.) - Jetë.

Zulm (ar.) - Shtypje, zënie fryme, mëkatëbërje, mëkatim: Keqbërësi. Fajkryerje.

Ndreqje gabimesh

Faqe	rreshti	Është shkruar	Duhet (lexuar)
1	2	3	4
14	16	ruajnë	ru anë
14	23	risnë	nisnë
15	7	bnjë	binjë
15	16	bëmë	bimë
19	1	e	u
24	10	brrmën	brrimënë
29	10	në.... në	ne.... ne
37	22	mbëuarrë	mbëluarë
39	8	xhuheavet	xhuhelavet
49	23	ata	ato
55	20	djelë	djeltë
56	8	ga këjo po më kërkojnë	ga sherr' i tiret shpëtomë
68	15	ruajnë	rujanë
91	23	rreshti i 3-të,	të lexohet i 4-rt.
95	1	e	–
95	9	Hajedni	Hajdeni
97	2	atë	ata
104	23	kababet	kabahet

1	2	3	4
121	11	Rroke	Broke
123	2	ashf	afsh
127	16	Mahut	Mabut
129	15	lekim	lexim
131	2	Më himadh	Mëshirëmadh
135	2	Xhedë	.....Farë e fis, pararendës

U dorëzua në shtyp në qershor 1992

Doli nga shtypi në Tetor 1992

Tirazhi: 6000 kopje Formati 70 x 100/16

Shtypur në Tipografinë Ushtarake.